



# Raporti i Transparencës 2018

**KPMG Albania Shpk**

[kpmg.com/al](http://kpmg.com/al)

# Përmbajtja

## **Mesazh nga Drejtorja Ekzekutive**

### **1 Kush jemi**

### **2 Struktura jonë dhe qeverisja**

### **3 Sistemi i kontrollit të cilësisë**

### **4 Informacioni financiar**

### **5 Shpërblimi i partnerit**

### **6 Rregullimi i rrjetit**

### **7 Deklarata e drejtuesve të KPMG Albania mbi efektivitetin e kontrolleve të cilësisë dhe pavarësisë**

## **Shtojca 1 Subjekte me Interes Publik**

### **Vlerat e KPMG-së**

# Mesazh nga Drejtorja Ekzekutive



Mirësevini në Raportin e Transparencës së KPMG Albania, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, i cili është përgatitur në përputhje me dispozitat e ligjit "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Raporti ynë i Transparencës do t'ju japë një pasqyrë të qartë të strukturës dhe qeverisjes sonë, kulturës dhe vlerave tona, si dhe proceseve kyçe dhe programeve të fuqishme që ne përdorim për të zhvilluar vazhdimisht cilësinë, për të ruajtur pavarësinë, integritetin dhe besueshmërinë e shërbimeve tona.

Cilësia, për ne, është themeli për biznesin tonë dhe ne marrim parasysh rëndësinë e të qenurit transparent për mënyrën se si qëndrojmë të rëndësishëm në mjedisin dinamik të biznesit me rritjen e pritshmërive të publikut.

Ne kemi një vizion të fortë për të ardhmen e KPMG-së. Përkushtimi ynë ndaj cilësisë është themelor dhe shpresojmë që ky raport të ofrojë një pasqyrë se si të gjithë individët në shoqërinë tonë punojnë me profesionalizëm çdo ditë për ta arritur atë.

Ju inkurajojmë të na kontaktoni nëse dëshironi të diskutoni ndonjë çështje të paraqitur në këtë raport. Është kënaqësi për ne të diskutojmë qasjen dhe pikëpamjet tona me ju.



**Alba Papisisto**  
**Drejtoreshë Ekzekutive**

# Kush jemi

## Seksioni 1

KPMG ALBANIA  
ËSHTE NJË SHOQËRI  
SHËRBIMESH PROFESIONALE  
UDHËHEQËSE NË VEND.

### 1.1 Biznesi Ynë

KPMG Albania Shpk<sup>1</sup> ("KPMG Albania" ose "shoqëria") është një shoqëri që ofron shërbime profesionale në Auditim, shërbime Fiskale dhe shërbime Konsulence.

KPMG Albania është një shoqëri e specializuar në auditim dhe është anëtare e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri ("IEKA" ose "Instituti"), e regjistruar me licencë Nr. 52 datë 7 maj 2003.

Hollësi të mëtejshme për ofrimin e shërbimeve tona mund të gjenden në faqen tonë të internetit në linkun e mëposhtëm: [kpmg.com/al](http://kpmg.com/al).

### 1.2 Strategjia Jonë

Strategjia e KPMG Albania është e bazuar në katër prioritete: të qenit i fokusuar ndaj tregut, i udhëhequr ndaj çështjeve, i shtyrë drejt ekselencës operacionale dhe të paturit e një kulture performance të lartë.

Përmes këtyre prioriteteve, vizioni ynë e përgjithshëm është të jemi zgjedhja më e mirë për të punuar.

Kjo përfshin të qenit shoqëri udhëheqëse në ofrimin e shërbimeve profesionale në shumë disiplina në Shqipëri, si dhe një ofruese shërbimesh cilësore për të gjithë klientët tanë, duke venë cilësinë në thelb të programit tonë. Si organizatë ne besojmë fort se tërheqim njerëz të jashtëzakonshëm dhe duke aplikuar ekspertizën tonë të thellë dhe njohuritë e sektorit ne jemi në gjendje të ofrojmë rezultate reale për klientët dhe komunitetin tone.

Ne vazhdojmë të ndërtojmë aftësitë tona për të plotësuar nevojat e klientëve në epokën dixhitale, veçanërisht në transformimin dixhital dhe të dhënave analitike.

<sup>1</sup> Gjatë gjithë këtij dokumenti, "KPMG" i referohet rrjetit të shoqërive të pavarura anëtare që veprojnë nën emrin e KPMG dhe të lidhura me KPMG International Cooperative ("KPMG International") ose me një ose më shumë prej këtyre shoqërive ose me KPMG International. KPMG International, një entitet zviceran, nuk u ofron shërbime klientëve. Gjatë gjithë këtij dokumenti, "KPMG" ("KPMG Albania", "Shoqëria", "Kompania", "ne", "ynë" dhe "ne") i referohet KPMG Albania Shpk. KPMG Albania Shpk është një shoqëri anëtare e rrjetit të shoqërive të pavarura të KPMG-së të lidhur me KPMG International Cooperative ("KPMG International").

# Struktura jonë dhe qeverisja

## Seksioni 2

### STRUKTURA JONË SIGURON VAZHDIMËSI DHE QËNDRUESHMËRI DHE NE ANGAZHOHEMI PËR ZBATIMIN E VLERAVE TË KPMG.

#### 2.1 Struktura ligjore

KPMG Albania është e lidhur me KPMG International Cooperative ("KPMG International"), një kooperativë Zvicerane e cila është një person juridik formuar sipas ligjit Zviceran. Është subjekti me të cilin të gjitha shoqëritë anëtare e rrjetit KPMG janë të lidhur. Hollësi të mëtejshme në lidhje me KPMG International dhe biznesit të tij, duke përfshirë edhe marrëdhëniet tona me të, janë në dispozicion në seksionin 'Qeverisja dhe Udhëheqja' në Raportin Ndërkombëtar të Transparencës së KPMG-së. KPMG Albania është pjesë e një rrjeti global të shoqërive të shërbimeve profesionale që ofrojnë shërbime profesionale në Auditim, shërbime Fiskale dhe shërbime Konsulente për një shumëllojshmëri të gjerë të organizatave të sektorit publik dhe privat. Struktura KPMG International është projektuar për të mbështetur qëndrueshmërinë e cilësisë së shërbimit dhe të respektimit të vlerave të miratuara ku shoqëritë anëtare veprojnë.

KPMG Albania është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 1999 sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Shqipëri. Shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Republikës së Shqipërisë me zyrë të regjistruar dhe adresë në: Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, kati 13-të, Tiranë, Shqipëri.

KPMG Albania është në pronësi të KPMG CEE Holdings Limited, Qipro. KPMG CEE Holdings Limited është një shoqëri auditimi e regjistruar në Qipro.

Administratorët e regjistruar të KPMG Albania janë, Alba Papparisto, Fatos Beqja dhe Tzvetelinka Koleva të cilët përfaqësojnë Shoqërinë individualisht.

Informacioni në lidhje me strukturën e pronësisë së shoqërisë, organet e saj të administrimit dhe rrethana të tjera të cilat janë subjekt i hyrjes në bazë të ligjit kanë qenë të regjistruar në mënyrë të rregullt dhe janë në dispozicion të publikut në Qendrën Kombëtare të Bizneseve.

Shoqëria ka një degë në Kosovë, të regjistruar në vitin 2005 në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me adresë në: Rruga Pashko Vasa, 6, Prishtinë, Kosovë.

#### 2.2 Emri, pronësia dhe marrëdhëniet ligjore

KPMG është markë e regjistruar e KPMG International dhe është emri me anë të të cilit njihen shoqëritë anëtare KPMG, duke përfshirë KPMG Albania. Të drejtat e shoqërive anëtare për të përdorur emrin KPMG dhe markën janë të përfshira në marrëveshjen me KPMG International.

Shoqëritë anëtare janë subjekte të veçanta juridike të cilat administrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat profesionale të shtetit respektiv. Çdo shoqëri anëtare është përgjegjëse për detyrimet dhe obligimet e veta. KPMG International dhe shoqëritë e tjera anëtare nuk janë përgjegjëse për detyrimet dhe obligimet e një shoqërie tjetër anëtare. Shoqëritë anëtare mund të përbëhen nga më shumë se një entitet juridik. Në këtë rast çdo subjekt i veçantë juridik do të jetë përgjegjës vetëm për obligimet dhe detyrimet e veta dhe, nëse nuk ka rënë dakord shprehimisht për të kundërtën.

#### 2.3 Përgjegjësitë dhe detyrimet e shoqërive anëtare

Në bazë të marrëveshjeve me KPMG International, shoqëritë anëtare janë të detyruara të jenë në përputhje me politikat dhe rregulloret e KPMG International, duke përfshirë standardet e cilësisë që rregullojnë mënyrën se si ata veprojnë dhe se si ato ofrojnë shërbime për klientët për të konkuruar në mënyrë efektive. Kjo përfshin të paturit e një strukture të fortë që siguron vazhdimësi dhe qëndrueshmëri dhe të jenë në gjendje të miratojnë strategji globale, burimet (hyrëse dhe dalëse), të shërbimit të klientëve shumë kombësh, të menaxhimit të rrezikut, dhe për të vendosur metodologjitë dhe mjetet globale.

Çdo shoqëri anëtare merr përgjegjësinë për administrimin e saj dhe cilësinë e punës së saj.

Shoqëritë anëtare angazhohen për një grup të përbashkët të vlerave të KPMG.

Aktivitetet e KPMG International financohen nga shumat e paguara nga shoqëritë anëtare. Baza për llogaritjen e shumave të tilla është aprovuar nga Bordi Global dhe zbatohet në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëritë anëtare. Statusi i një shoqërie si një shoqëri anëtare e KPMG dhe pjesëmarrja e saj në rrjetin e KPMG mund të ndërpritet nëse, ndër të tjera, nuk ka vepruar në përputhje me politikat dhe rregullat e vendosura nga KPMG International ose nëse ka ndonjë detyrim të pashlyer ndaj saj.

# Sistemi i kontrollit të cilësisë

## Seksioni 3

Në KPMG cilësia e auditimit nuk ka të bëjë vetëm me marrjen e opinionit të duhur por dhe me se si arrihet në atë opinion

### 3.1 Vështrim i përgjithshëm

Një sistem i qëndrueshëm Kontrolli Cilësie është një kërkesë thelbësore për kryerjen e shërbimeve me cilësi të lartë.

Rrjedhimisht, KPMG International ka politikat e kontrollit të cilësisë që vlejnë për të gjitha shoqëritë anëtare. Këto janë të përfshira në Manualin Global të Menaxhimit të Rrezikut dhe Cilësisë (GQ&RMM) në dispozicion për të gjithë stafin e KPMG.

Këto politika dhe procedura janë hartuar për të ndihmuar shoqëritë anëtare që të veprojnë në përputhje me standardet përkatëse profesionale, kërkesat rregullatore dhe ligjore, dhe të lëshojnë raporte të përshtatshme në rrethana të caktuara, si dhe të ndihmojnë stafin e shoqërive anëtare të veprojnë me integritet dhe objektivitet për të kryer punën e tyre me kujdes.

Këto politika bazohen në Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1 (ISQC 1), të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardeve Siguruese (IAASB), dhe Kodi i Etikës për Kontabilistët të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA). Të gjitha këto të rëndësishme për shoqëritë anëtare që kryejnë auditime ligjore dhe angazhime shërbimesh të ngjashme.

KPMG Albania kërkohet të zbatojë politikat dhe procedurat e KPMG International dhe gjithashtu adopton politika dhe procedura shtesë të cilat janë projektuar për të përmbushur rregullat dhe standardet e nxjerra nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike ("Bordi"), rregullat dhe standardet e rregullatorëve të tjerë të rëndësishëm dhe kërkesat ligjore të tjera relevante të aplikueshme<sup>1</sup>. Duke integruar politikat dhe procedurat kryesore, ky sistem gjithashtu lehtëson përputhshmërinë me rregulloret e Bordit.

Ndryshime të politikave Kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë politikat për etikën dhe pavarësinë, janë komunikuar me postë elektronike. KPMG Albania duhet të zbatojë ndryshimet e specifikuara nëpërmjet komunikimeve me postë elektronike dhe kjo kontrollonhet përmes monitorimit të brendshëm.

Kontrolli i cilësisë dhe menaxhimi i rrezikut janë përgjegjësi e të gjithë personelit të KPMG-së. Kjo përgjegjësi përfshin nevojën për të kuptuar dhe për t'ju përmbajtur politikave dhe procedurave përkatëse të shoqërive anëtare në kryerjen e aktiviteteve të tyre ditore. Sistemi i kontrollit të cilësisë zbatohet për personelin e KPMG kudo ku ata ndodhen.

Ndërsa shumë procese të kontrollit të cilësisë së KPMG janë ndër-funksionale, dhe që zbatohen në mënyrë të barabartë edhe për departamentin e shërbimeve fiskale dhe konsulencës, pjesa e mbetur e këtij seksioni fokusohet në cilësisë ne auditimit.

### 3.2 Struktura e cilësisë së auditimit

Në KPMG Albania, cilësia e auditimit nuk ka të bëjë vetëm me arritjen e opinionit të duhur, por mënyra se si ne e arrijmë atë opinion. Ka të bëjë me proceset, mendimet dhe integritetin pas raportit të auditimit. Rezultati i një auditimi cilësor është ofrimi i një opinionit të përshtatshëm dhe të pavarur në përputhje me standardet e duhura profesionale dhe me kërkesat ligjore dhe rregullatore të aplikueshme në këtë rast.

Në mënyrë që të ndihmojmë të gjithë audituesit që të përqëndrohen në aftësitë themelore të kërkuara për të ofruar një auditim cilësor KPMG International ka zhvilluar Strukturën tonë globale të Kontrollit të Cilësisë së Auditimit.


Struktura jone paraqet një gjuhë të përbashkët që zbatohet nga të gjitha shoqëritë anëtare të KPMG-së, përfshirë KPMG Albania, për të përshkuar atë që ne besojmë se drejton cilësinë e auditimit dhe

<sup>1</sup> Të gjitha referencat e "Politikat dhe procedurat e KPMG" ose "politikat dhe procedurat tona" i referohen politikave të KPMG International sëbashku me politikat e KPMG Albania.



thekson mënyrën se si çdo auditues profesional në çdo shoqëri anëtare të KPMG kontribuon në lëshimin e një raporti auditimi cilësor.

“Tone at the top” është thelbi i Strukturës të Cilësisë së Auditimit dhe një ndër shtatë parimet e cilësisë së auditimit dhe ndihmon në sigurimin e sjelljeve të duhura që përshkojnë gjithë strukturën tonë. Të gjithë parimet krijojnë një rreth virtuoze pasi secili ka për qëllim të forcojë parimet e tjera. Secili prej këtyre shtatë parimeve thelbësore është përshkruar më me hollësi në seksionet në vijim të këtij raporti.



### 3.3 Tone at the top

Kultura e KPMG International dhe shoqërive anëtare KPMG mbështetet nga një grup i fortë vlerash, politika dhe procese mbështetëse dhe mundëson qëndrimet e duhura dhe sjelljet që përshkojnë të gjithë rrjetin KPMG.

Drejtimi jonë global, duke punuar me drejtuesit rajonal dhe ata të shoqërive anëtare, luan një rol të rëndësishëm në angazhimin tonë ndaj cilësisë dhe standardeve më të larta të përsosmërisë profesionale. Një kulturë e bazuar në cilësi, integritet dhe etikë është thelbësore në një shoqëri që kryen auditime dhe shërbime të tjera në të cilat, palët e interesuara dhe investitorët, mbështeten.

Në KPMG Albania, ne promovojmë një kulturë në të cilën konsultimi inkurajohet dhe njihet si aftësi.

“Tone at the top” do të thotë se drejtimi i KPMG Albania tregon dhe komunikon qartë përkushtimin

e saj ndaj cilësisë, etikës dhe integritetit dhe komunikon përkushtimin e saj ndaj klientëve, palëve të interesuara dhe shoqërisë në tërësi.

Integriteti është një karakteristikë e rëndësishme që palët e interesuara presin dhe në të cilin mbështeten. Është gjithashtu thelbi i vlerave kryesore të KPMG-së - Mbi të gjitha, ne veprojmë me integritet. Integritet do të thotë përpjekje e vazhdueshme për të mbajtur standardet më të larta profesionale, duke siguruar këshillim me cilësi të lartë dhe ruajtjen e pavarësisë në mënyrë rigorozë.

Vlerat e KPMG-së, të cilat janë të kodifikuara në mënyrë të qartë prej disa vitesh, janë të ngulitura në praktikën dhe kulturën e vlerave në bazë të pajtueshmërisë duke punuar në KPMG Albania. Vlerat e KPMG-së formojnë themelin e kulturës sonë dhe vendosin vlerën “tone at the top”. Ato gjithashtu formojnë themelin e qasjes së KPMG-së për të audituar dhe për të formuar mënyrën se si punojmë së bashku.

Ne i komunikojmë qartë vlerat e KPMG-së për personelin tonë dhe i pasqyrojmë ato nënë programet për personelin – trajnimin njohës të KPMG, zhvillimin e performancës dhe shpërbimin. Vëmendje e veçantë i kushtohet vlerave tona të KPMG për promovime të nivelit të lartë, duke përfshirë Partnerin

Vlerat tona janë të përcaktuara këtu.

#### Kodi Global i Sjelljes së KPMG-së

Angazhimi i KPMG-së për integritet dhe cilësi reflektohet në vlerat e KPMG-së që përbëjnë thelbin e mënyrës se si ne punojmë. Ato përcaktojnë kulturën e larmishme dhe gjithpërfshirëse të KPMG-së dhe angazhimin tonë për sjelljen e duhur personale dhe profesionale. Vlerat e KPMG-së theksojnë se, mbi të gjitha, stafi i KPMG-së vepron me integritet, mbështesin standardet më të larta profesionale dhe japin këshilla të vlefshme, duke ruajtur rigorozisht pavarësinë dhe duke respektuar ligjet, rregulloret dhe standardet profesionale. Vlerat e KPMG-së komunikohen qartë tek të gjithë personat dhe janë aplikuar në programet për personelin e shoqërive anëtare – trajnimi njohës të KPMG, zhvillimin e performancës dhe shpërbimin.

Ndërtimi i vlerave të KPMG-së është Kodi Global i Sjelljes së KPMG. Shoqëritë anëtare, përfshirë KPMG Albania, janë të detyruar të zbatojnë, si minimum, Kodin Global të Sjelljes.

Për më tepër, Kodi Global i Sjelljes i KPMG përcakton pritshmëritë e sjelljes etike për të gjithë partnerët dhe punonjësit e KPMG Albania dhe është ndërtuar mbi bazën e vlerave të KPMG-së, besimeve të përbashkëta dhe parimeve të KPMG-së.

Përveç kësaj, Kodi Global i Sjelljes thekson se secili partner dhe punonjës është personalisht përgjegjës për ndjekjen e standardeve ligjore, profesionale, etike dhe që vlejën për funksionin e tij ose të saj të punës dhe nivelit të përgjegjësisë. Kodi Global i Sjelljes i KPMG-së përfshin dispozita të cilat kërkojnë që stafi i KPMG Albania të:

- Veprojnë në përputhje me të gjithë ligjet, rregulloret, standardet profesionale dhe politikat e KPMG Albania
- Punojnë me klientët dhe palë të treta të duhur
- Përqendrohen në cilësi
- Të ruajnë objektivitetin dhe pavarësinë
- Të mos tolerojnë asnjë veprim të paligjshëm ose jo etik, kryer brenda KPMG Albania, nga palët e treta, ose nëpunësit me të cilët punojmë
- Mbrojnë informacionin
- Konkurojnë në mënyrë të drejtë
- Ndihmojnë stafin tonë të jenë të jashtëzakonshëm
- Janë qytetarë të përgjegjshëm
- Krijojnë besim publik

I gjithë personeli i KPMG Albania duhet të:

- Të jetë në pajtueshmëri me Kodin Global të Sjelljes dhe të konfirmojnë se kuptojnë dhe do të veprojnë në përputhjen me Kodin e Sjelljes pasi bëhen pjesë e KPMG-së dhe çdo vit pas këëtij momenti; dhe
- Të kryejë trajnim të rregullt mbi Kodin e Sjelljes pasi bëhen pjesë e KPMG-së dhe në baza dyvjeçare pas këtij momenti

Individët inkurajohen të ngrënë shqetësimet e tyre kur shohin diçka që u shkakton shqetësim ose që nuk është në përputhje me vlerat e KPMG-së. Për më tepër, gjithsesecili në KPMG është përgjegjës për raportimin dhe kërkohet të raportojë çdo aktivitet që mund të jetë i paligjshëm ose në kundërshtim me vlerat e KPMG-së, politikat e KPMG-së, ligjeve të aplikueshme, rregulloret, ose standardet profesionale.

Ne kemi procedura dhe kemi ndërtuar kanale komunikimi në mënyrë që personeli ynë të raportojë çështjet etike dhe të cilësisë. Shpagimi kundër individëve që 'ngrenë zërin' dhe raportojnë në mirëbesim është i ndaluar.

Përveç kësaj, një [linjë për ankesa e KPMG International](#) është vënë në dispozicion të gjithë, partnerëve të KPMG-së, personelit, klientëve dhe palëve të tjera për të raportuar në mirëbesim shqetësimet që ata kanë në lidhje me fusha të caktuara të veprimtarisë të vetë KPMG International, shoqëritë anëtare KPMG ose drejtimin më të lartë, ose punonjësit e shoqërive anëtare KPMG.

Në KPMG Albania, ne monitorojmë rregullisht shkallën në të cilën njerëzit tanë ndjejnë se ne jetojmë vlerat e KPMG-së nëpërmjet Anketimit Global për Njerëzit (referoju [3.7.7 Këndvështrime nga njerëzit tanë- Anketimi Global për Njerëzit \(GPS\)](#)).

### 3.4 Përgjegjësitë e Drejtimit për cilësinë dhe menaxhimin e rrezikut

KPMG Albania tregon përkushtim ndaj cilësisë, etikës dhe integritetit, dhe komunikon fokusin e saj në cilësi ndaj klientëve, palëve të interesuara dhe shoqërisë. Drejtimi luan një rol kryesor në vendosjen e tonit të duhur dhe udhëheqjes nga shembulli, duke demonstruar një angazhim të palëkundur ndaj standardeve më të larta të përsosmërisë profesionale dhe duke përkrahur dhe mbështetur iniciativat e mëdha.

Ekipi ynë drejtues angazhohet për ndërtimin e një kulture në bazë të cilësisë, integritetit dhe etikës, demonstruar përmes veprimeve të tyre – nëpërmjet komunikimit të shkruar dhe video, prezantime në grupe dhe diskutime individuale.

Individët e mëposhtëm kanë përgjegjësi drejtimi lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë dhe menaxhimit të rrezikut në KPMG Albania.

#### 3.4.1 Partneri Ekzekutiv i Ballkani

Në përputhje me parimet në ISQC1, Partneri Ekzekutiv i Ballkanit ka marrë përgjegjësinë e plotë për sistemin e kontrollit të cilësisë të KPMG Albania.

#### 3.4.2 Partneri i Menaxhimit të Rrezikut

Përgjegjësia operacionale për sistemin e kontrollit të cilësisë dhe pajtueshmëria për menaxhimin e rrezikut të KPMG Albania i është deleguar Partnerit

të Menaxhimit të Rrezikut, i cili është përgjegjës për vendosjen e politikave profesionale të kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të rrezikut si edhe monitorimin e përputhshmërisë për Shoqërinë. Partneri i Menaxhimit të Rrezikut përdor një linjë të drejtpërdrejtë raportimi me Partnerin Ekzekutiv. Ajo këshillohet me Drejtuesin e Menaxhimit të Cilësisë dhe Rrezikut në Rajon. Vjetërsia e linjave të raportimit, nënvizon rëndësinë që Shoqëria i kushton çështjeve të rrezikut dhe të cilësisë. Partneri i Menaxhimit të Rrezikut mbështetet nga ekipi qendror i menaxhimit të rrezikut dhe cilësisë dhe një ekip partnerësh dhe profesionistësh në secilin prej funksioneve.

### 3.4.3 Partneri i Etikës dhe Pavarësisë

Partneri i Etikës dhe Pavarësisë ka përgjegjësinë kryesore për drejtimin dhe ekzekutimin e politikave dhe procedurave të etikës dhe pavarësisë në KPMG Albania dhe raporton mbi çështjet e etikës dhe pavarësisë te Partneri Ekzekutiv dhe Partneri i Menaxhimit të Rrezikut.

### 3.4.4 Funksionet e Auditit, Shërbimeve Fiskale dhe Konsulencës – Drejtuesit

Drejtesit e funksioneve të shërbimit të klientit (Auditim, Shërbime Fiskale dhe Konsulencë) janë në dispozicion të Partnerit Ekzekutiv për cilësinë e shërbimit të kryer në funksionet e tyre përkatëse. Mes tyre, ata përcaktojnë funksionimin dhe monitorimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe rrezikut për funksionet e tyre specifike brenda kornizës së vendosur nga Partneri i Menaxhimit të Rrezikut dhe Cilësisë.

Këto procedura bëjnë të qartë se në nivel angazhimi, menaxhimit të rrezikut dhe kontrollet e cilësisë janë përgjegjësi e plotë e të gjithë profesionistëve.

Drejtesit e Auditimit të KPMG Albania është përgjegjës për udhëheqjen e një praktike të qëndrueshme të auditimit të cilësisë së lartë që është tërheqëse për personelin e KPMG. Kjo përfshin:

- Vendosjen e drejtë “tone at the top” duke demonstruar një angazhim të palëkundur për standardet më të larta të përsosmërisë profesionale dhe skepticizmit, objektivitetit dhe pavarësisë
- Zhvillimin dhe zbatimin e strategjive për të monitoruar dhe për të ruajtur njohuritë dhe aftësitë e nevojshme të partnerëve dhe punonjësve për të përmbushur përgjegjësitë e tyre profesionale

- Bashkëpunimin me Partnerin e Menaxhimit të Rrezikut për të monitoruar dhe adresuar çështjet të cilësisë dhe rrezikut që kanë të bëjnë me praktikën e Auditimit, duke përfshirë një vlerësim vjetor të veprimtarive që konsiderohet të jenë kyçe për cilësinë e auditimit.

### 3.4.5 Drejtuesit e Ekipit të Auditimit

Në Takimet e Ekipit të Drejtuesëve të Auditimit janë përfshirë diskutime të rregullta për çështje ekzistuese dhe të reja të cilësisë së auditimit që dalin nga proceset e rishikimit të cilësisë së jashtme dhe të brendshme, pyetje ngritur nga ekipet e angazhimit, procedura analizuese për shkaqet kryesore, dhe çështje të tjera të cilësisë të identifikuar nga një shumëllojshmëri burimesh. Këto diskutohen dhe duke marrë në konsideratë vëzhgime të tjera të mbledhura nga ekipet e angazhimit, dakordësohet për veprimet në vazhdim. Zakonisht, shumica e këtyre veprimeve janë afatshkurtra dhe në secilin rast ato shtjellohen dhe komunikohen përmes takimeve përmbledhëse të rregullta teknike për të gjithë departamentin e auditimit dhe nëse konsiderohen të rëndësishme, përfshihen në trajnimin e ardhshëm të detyrueshëm. Për çështjet më të ndërlikuara (të cilat mund të kërkojnë ndryshime në metodologjinë e auditimit të KPMG-së globale ose mjetet e auditimit) këto do të ngrihen për shqyrtim me KPMG International Global dhe zhvillim të mundshëm nga Qendra e Shërbimeve Globale (GSC) dhe Grupi i Standardeve Ndërkombëtar (ISG). Për më shumë informacion rreth GSC dhe ISG referoju seksioneve [Qendra e Shërbimeve Globale \(GSC\)](#) dhe [Grupi i Standardeve Ndërkombëtar \(ISG\)](#).

### 3.4.6 Investimi në përmirësim të vazhdueshëm

Në nivel global, KPMG International ka prezantuar një numër ndryshimesh pasi rrjeti i KPMG-së vazhdon të investojë në përmirësimin e vazhdueshëm. Këto përfshijnë krijimin e Komitetit Global të Cilësisë të Auditimit pjesë e Bordit Global, i përbërë nga Partnerët e Lartë të shoqërive më të mëdha në rrjetin KPMG dhe emërimin e një Drejtuesi të Cilësisë Globale të Auditimit i cili i raporton komitetit.

### Çfarë është cilësia e auditimit?

Cilësia e auditimit është thelbësore për ruajtjen e besimit publik dhe është masa kryesore në të cilën mbështetet reputacioni ynë profesional.

Ne përcaktojmë 'cilësinë e auditimit' si rezultat që vjen kur:

- Auditimet kryhen vazhdimisht, në përputhje me kërkesat dhe qëllimin e standardeve të aplikueshme profesionale, brenda një sistemi të fuqishëm të kontrolleve të cilësisë; dhe
- Të gjitha aktivitetet tona ndërmerren në një mjedis të nivelit maksimal të paanshmërisë, pavarësisë, etikës dhe integritetit.

### 3.5 Lidhja me klientët e duhur

Një nga pikat kyçe për menaxhimin e cilësisë së auditimit është të kuptojmë natyrën e klientëve tanë dhe çështjet me të cilat ata përballen dhe të ndërtojmë një përgjigje të fuqishme të auditimit ndaj rreziqeve të identifikuar.

Kuptojmë se klientët tanë janë të lidhur me cilësinë e punës dhe reputacionin tonë.

Politikat dhe proceset rigorozë të pranimit dhe vazhdimësisë së angazhimeve me klientët, janë jetike për aftësinë tonë për të siguruar shërbime me cilësi të lartë profesionale dhe për të mbrojtur reputacionin e KPMG-së dhe për të mbështetur emrin e KPMG-së.

#### 3.5.1 Pranimi dhe vazhdimi i klientëve dhe angazhimeve

KPMG International ka caktuar politika dhe procedura të cilat janë zbatuar nga të gjitha shoqëritë anëtare për të vendosur nëse duhet të pranojnë apo të vazhdojnë një marrëdhënie me klientin dhe nëse duhet të kryhet një angazhim specifik për atë klient.

#### 3.5.2 Klienti dhe procesi i vlerësimit të angazhimit

##### Vlerësimi i Klientit

KPMG kryen një vlerësim të çdo klienti të ardhshëm.

Kjo përfshin marrjen e informacioneve të mjaftueshme për klientin e ardhshëm, drejtimin e tij kryesor, pronarët dhe përfituesit më të rëndësishëm dhe më pas analizimin e duhur të informacionit për të qenë në gjendje të ndërmarrim një vendim të mirë informuar për pranim. Ky vlerësim përfshin plotësimin e një pyetësori për të vlerësuar profilin e rrezikut të klientit dhe marrjen e informacionit të aktivitetit mbi të, drejtuesit dhe pronarët e tij kryesorë. Përveç kësaj, ne kërkojmë informacion

shtesë për të përmbushur kërkesat ligjore dhe ato rregullative.

Një Partner i dytë, si dhe Partneri vlerësues, miraton vlerësimin klientit të ardhshëm. Kur klienti konsiderohet si me "rrezik të lartë" një partner i menaxhimit të rrezikut ose një person mjaft i kualifikuar dhe me përvojë përfshihet në miratimin e vlerësimit.

##### Vlerësimi i Angazhimit

Çdo angazhim i ardhshëm vlerësohet gjithashtu për të identifikuar rreziqet e mundshme në lidhje me të. Për këtë vlerësim merren parasysh një sërë faktorësh, përfshirë pavarësinë dhe çështjet e konfliktit të interesit (duke përdorur Sentinel-in, sistemin tonë global të kontrollit të konflikteve dhe pavarësisë), qëllimin e synuar dhe përdorimin e rezultateve të angazhimit, si dhe faktorë të veçantë për llojin e angazhimit. Për angazhime të auditimit, këto përfshijnë kompetencat e ekipit të drejtimit financiar të klientit si dhe aftësitë dhe eksperiencën e personelit të ngarkuar për angazhimin specifik. Vlerësimi bëhet duke u këshilluar me personel tjetër me eksperiencë brenda KPMG Albania dhe përfshin rishikimin nga drejtuesit e menaxhimit të rrezikut dhe cilësisë, sipas kërkesës.

Kur ofrohen shërbime auditimi për herë të parë, ekipit të angazhimit i kërkohet të kryejë procedura shtesë për vlerësimin e pavarësisë, duke përfshirë rishikimin e ndonjë shërbimi jo-auditimi që i është ofruar klientit dhe të marrëdhënieve të tjera të rëndësishme biznesi apo personale.

Vlerësime të ngjashme të pavarësisë kryhen kur një klient ekzistues i auditimit bëhet një entitet me interes publik apo në rastin kur kufizime të tjera të pavarësisë zbatohen si pasojë e ndonjë ndryshimi në rrethanat e klientit.

Ne ndjekim procedura specifike (të detajuara më tej në seksionin "Procesi i pastrimit të pavarësisë") për të identifikuar dhe vlerësuar çënimin e pavarësisë për klientët e mundshëm të auditimit që janë entitete me interes publik.

Në varësi të vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut të klientit dhe të angazhimit të ardhshëm, mund të kërkohen edhe masa shtesë për të ndihmuar zbutjen e rreziqeve të identifikuar. Çdo çështje pavarësie apo konflikti i interesit duhet të dokumentohet dhe zgjidhet përpara se të pranohet.

Një klient apo angazhim i ardhshëm nuk do të pranohet nëse një çështje e mundshme pavarësisht apo konflikti nuk mund të zgjidhet në mënyrën e duhur në përputhje me standardet profesionale dhe standardet e politikave të shoqërisë, ose nëse ekzistojnë çështje të tjera të cilësisë dhe të rrezikut që nuk mund të zgjidhen në mënyrën e duhur.

### 3.5.3 Procesi i vazhdimësisë

KPMG Albania rivlerëson çdo vit të gjithë klientët dhe angazhimet e auditimit.

Rivlerësimi identifikon çdo çështje në lidhje me vazhdimësinë e marrëdhënies dhe çdo procedurë shtesë për menaxhimin e rrezikut që duhet zbatuar (kjo mund të përfshijë caktimin e profesionistëve të tjerë të tillë si një Rishikues të Kontrollit të Cilësisë (EOC) ose nevojën për përfshirjen e ekspertëve të tjerë gjatë një auditimi).

Rivlerësimi vlen edhe për ato angazhime të cilat ripërsëriten apo të cilat zgjasin për një periudhë kohore relativisht të gjatë.

Gjithashtu, klientët dhe angazhimet duhen rivlerësuar në rastet kur ka tregues se mund të ketë ndryshime në profilin e tyre të rrezikut.

### 3.5.4 Tërheqja

Kur marrim informacion që tregon se duhet të tërhiqemi nga një angazhim ose nga marrëdhënia me një klient, ne konsultohemi së brendshmi dhe identifikojmë masat e nevojshme ligjore, profesionale dhe përgjegjësitë rregullative. Ne gjithashtu komunikojmë sipas nevojës me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe çdo autoritet tjetër përkatës.

### 3.5.5 Administrimi i portofoleve të klientëve

Partnerët e angazhimit dhe audituesit ligjorë kyç të cilët kanë kompetencat e duhura, aftësitë, kohën dhe autoritetin për të kryer këtë rol, emërohen për çdo angazhim.

Ne shqyrtojmë çdo portofol klienti të partnerit të auditimit të paktën çdo vit në diskutime individuale me partnerin e auditimit. Gjatë shqyrtimeve marrim në konsideratë industrinë, natyrën dhe rrezikun e portofolit të klientëve të tjerë së bashku me kompetencën, aftësitë dhe kapacitetin e partnerit për të kryer një auditim cilësor për çdo klient.

Portofoli i klientëve të secilit drejtues angazhimi rishikohet rregullisht nga Drejtuesi i Auditimit për të siguruar që ata kanë kohë të mjaftueshme për të menaxhuar portofolin dhe për të siguruar që rreziqet të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme.

## 3.6 Standarde të qarta dhe mjete të qëndrueshme auditimi

Të gjithë profesionistët e KPMG Albania pritet që t'i përmbahen politikave dhe procedurave të KPMG International dhe KPMG Albania (përfshirë dhe politikave të pavarësisë), dhe janë pajisur me një sërë mjete për t'i mbështetur ata në arritjen e këtyre pritshmërive. Politikave dhe procedurat e caktuara për angazhimet e auditimit përfshijnë kërkesat e duhura të standardeve të kontabilitetit, auditit, etikës, kontrollit të cilësisë si dhe kërkesat e ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me to.

### 3.6.1 Qasja jonë ndaj auditimit

KPMG ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e aftësive të rrjetit të auditimit dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë në vitet e ardhshme duke përfshirë një proces global pune të ri elektronik të auditimit të ofruar përmes platformës KPMG Clara - platforma e zgjuar dhe modulare e auditimit e KPMG - e aftë për të integruar vazhdimisht teknologjitë e reja dhe ato në zhvillim, me aftësi të avancuara të përpunimit të të dhënave, automatizimi dhe vizualizimi. Të dhënat dhe analiza (D&A) janë pjesë përbërëse e rëndësishme e mënyrës se si shoqëritë anëtare të KPMG marrin evidencatë auditimit dhe bashkëveprojnë me klientët në epokën dixhitale.

Procesi i auditimit me cilësi të lartë i KPMG-së do të vazhdojë të përfshijë:

- Partnerë dhe menaxherë në kohën e duhur gjatë angazhimit
- Qasjen në njohuritë e duhura duke përfshirë pjesëmarrjen e specialistëve, kërkesat për trajnim dhe përvojë si dhe ekspertizën për industrinë përkatëse
- Vlerësimin kritik të të gjitha provave të auditimit të përfituara gjatë auditimit, duke dhënë një gjykim të duhur profesional
- Këshillimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e vazhdueshëm të ekipit të angazhimit
- Drejtimin dhe dokumentimin e auditimit.

## Metodologjia dhe mjetet e qëndrueshme të auditimit

Burime domethënëse i kushtohen ruajtjes dhe përditësimit të standarteve dhe mjeteve tona. Metodologjia jonë globale e auditit të KPMG-së, përpiluar nga Qendra Globale e Shërbimeve (GSC), bazohet në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs). Metodologjia e auditimit të KPMG-së përshkruhet në Manualin e Auditimit të KPMG-së (KAM) duke përfshirë gjithashtu edhe pika që shkojnë përtej ISAs që për të cilat KPMG beson se përmirësojnë më tej cilësinë e auditimit. Metodologjia thekson zbatimin e skepticizmit të duhur profesional në ekzekutimin e procedurave të auditimit dhe kërkon pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike, duke përfshirë pavarësinë. Përmirësimet në metodologji, udhëzimet dhe mjetet e auditimit bëhen rregullisht për të qenë në përputhje me standardet, fushat e auditimit që dalin në fokus dhe rezultatet e cilësisë së auditimit (të brendshëm dhe të jashtëm). Temat kyçe përfshijnë vlerësimet kontabël, kontrollin e brendshëm, njohjen e të ardhurave, auditimet e grupeve, marrjen e shembujve të auditimit dhe vlerësimin e rrezikut.

Shoqëritë anëtare KPMG mund të shtojnë kërkesat lokale dhe / ose udhëzime në KAM në përputhje me kërkesat shtesë profesionale, ligjore, apo rregullatore.

KAM, përveç të tjerash, përmban procedura që kanë për qëllim identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale dhe procedurat për t'ju përgjigjur këtyre risqeve të vlerësuara.

Metodologjia e auditimit të KPMG-së inkurajon kur është e nevojshme, përfshirjen e specialistëve përkatës në ekipin e angazhimit, nëse kriteret specifike plotësohen ose ku ekipi e konsideron të përshtatshme ose të nevojshme.

Rregullat dhe procedurat të vendosura në KAM janë specifike për auditime dhe i bashkëngjiten rregullave dhe procedurave të vendosura në Manualin Global të Menaxhimit të Rrezikut dhe Cilësisë (GQ&RMM), i cili është i aplikueshëm për të gjitha shoqëritë anëtare të KPMG-së, funksioneve dhe personelit, dhe është përshtatur nga KPMG Albania sipas politikave dhe procedurave vendase.

Procesi i punës i KPMG-së për auditimin mundësohet përmes platformës eAudit-it, një proces pune me bazë aktivitetesh dhe dosje elektronike të auditimit. eAudit është procesi i punës së dokumentimit të auditimit të KPMG-së që lejon mbi 75,000 profesionistë për të kryer auditime

të cilësisë së lartë dhe të qëndrueshme. eAudit integron metodologjinë e KPMG-së për auditim, udhëzimet dhe njohuritë e industrisë, si dhe mjetet e nevojshme për të ekzekutuar dhe dokumentuar punën e auditimit të kryer.

eAudit mund të “për-shkallëzohet” për të paraqitur kërkesat dhe udhëzimet përkatëse, në varësi të natyrës së subjektit që do të auditohet dhe në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullative. Ai siguron qasje të drejtpërdrejtë në udhëzimet tona të auditimit, standardet profesionale dhe modelet e dokumentimit.

Investime të rëndësishme janë duke u zhvilluar për të rishikuar dhe përmirësuar metodologjinë e auditimit të KPMG (KAM) dhe platformën eAudit, duke implementuar platformën e re të punës, KPMG Clara, e cila ka filluar fazën pilot në 2018, e planifikuar për implementim fillestar në nivel global në 2019, dhe implementimi i saj i plotë në 2020. Referojuni seksionit KPMG Clara, Platforma KPMG Clara, Tëdhënat analitike (D&A) për më shumë detaje mbi platformën KPMG Clara.

## KPMG Clara, Platforma KPMG Clara dhe të dhënat analitike (D&A)

KPMG International po bën investime të rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e auditimit, për të rritur qëndrueshmërinë në kryerjen e auditimeve dhe për të fuqizuar shoqërinë anëtare dhe monitorimin global të angazhimeve.

### KPMG Clara

Në vitin 2017, KPMG International filloi lançimin global të platformës Smart Audit të KPMG Clara, duke sjellë së bashku aftësitë e auditimit të të dhënave analitike të KPMG-së (D&A), teknologjitë e reja inovative, aftësitë e bashkëpunimit dhe platformën e punës së auditimit.

Kjo përfaqëson ambicien e KPMG për:

- Transformimin dhe ekzekutimin e auditimit për njerëzit dhe klientët tanë nëpërmjet ndërfaqeve të reja, bashkëkohore dhe moderne të teknologjisë dhe mjete për bashkëpunim.
- Integrimin e aftësive të kërkuara për të dixhitalizuar auditimin dhe për të ofruar rutinat e reja të d&a;
- Mundësimin e një procesi pune të përmirësuar dhe të ri-krijuar në aspektin pamor;

- Inkorporimin e zhvillimit të aftësive të monitorimit në nivelin e angazhimit dhe ndërmjet portofoleve të angazhimit për përdorim nga ekipet e angazhimit dhe shoqëritë anëtare;
- Të mbështetur mbikëqyrjen e drejtuesve globalë për efikasitetin e sistemeve të kontrollit të cilësisë të shoqërive anëtare; dhe
- Zhvillimin e një platforme me mundësi zgjerimi të auditimit për t'i mundësuar shoqërive anëtare përshtatje dhe shkallëzimin të platformës, si dhe përmirësime të tjera në të ardhshme.

KPMG Clara gjithashtu përfshin gjurmimin e treguesve të përzgjedhur në nivel angazhimi nga ekipet e punës për një angazhim individual dhe ndërmjet portofoleve të angazhimit. Kjo siguron një përmbledhje dhe vizualizim të këtyre treguesve për të:

- Matur progresin e angazhimit të auditimit dhe sigurimin e zgjidhjes në kohë të çështjeve;
- Lehtësuar zhvillimin e auditimit duke siguruar treguesit kryesorë për detyrat më të rëndësishme; dhe
- Nxjerrë në dukje rezultatet/marrëdhëniet e papritura që mund të kërkojnë shqyrtime të mëtejshme.

KPMG Clara do të pasurohet me kalimin e kohës pasi zhvillimet e teknologjisë vazhdojnë ta transformojnë auditimin, me fusha si teknologjia inteligjente dhe parashikuese që kanalizohen përmes KPMG Clara për të ofruar aftësi gjithnjë e më të mëdha. Përmes bashkëpunimit me disa nga shoqëritë më të avancuara të teknologjisë në botë si Microsoft, KPMG po ndërton të ardhmen e auditimit, duke u rreshtuar me kryesuesit e teknologjisë për të sjellë njohuri të reja më të shpejta dhe, me aftësi në rritje, duke ofruar më shumë vlerë përmes shoqërive të auditimit anëtare të KPMG. Strategjia e investimeve e KPMG International përfshin gjithashtu inovacionin, duke punuar me universitetet për kërkime të rëndësishme të aplikuar mbi auditimin dhe duke punuar me shoqëritë anëtare, ndërsa zhvillojnë teknologji të përparura.

### Platforma KPMG Clara

Duke u bazuar në prezantimin e KPMG Clara në vitin 2017, KPMG International po krijon një mjet të ri të punës që do të përdoret nga ekipet e auditimit të KPMG-së për të kryer dhe dokumentuar auditimet

e KPMG-së. Do të jetë intuitive, miqësore në përdorim dhe moderne. Sistemi i ri do të jetë në thelb një strukturë pune- që do të udhëzojë ekipet e auditimit përmes një sërë hapash në një mënyrë logjike, me një paraqitje më të qartë të informacionit, njohurive dhe udhëzimeve të disponueshme në momentin e nevojës dhe me aftësitë e avancuara të D&A. Stuktura e punës dhe metodologjia do të jenë gjithashtu të shkallëzueshme – duke përshtatur kërkesat në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të angazhimit të auditimit. Ky projekt i udhëhequr globalisht do të përmirësojë ndjeshëm dhe do të rikrijojë mënyrën e kryerjes së një auditimi nga profesionistët e KPMG-së dhe do të nxisë përmirësime në cilësinë e auditimit.

Platforma KPMG Clara do të përfshijë zhvillimin e aftësive të monitorimit (p.sh. burimet e të dhënave) në nivelin e angazhimit për përdorim nga shoqëritë anëtare. KPMG Clara ka filluar të pilotohet në 2018, e planifikuar të fillojë vënien në zbatim në nivel global në 2019, dhe zbatimi i saj i plotë në 2020. Platforma e mëparshme e auditimit, eAudit, pritet të mos përdoret më në vitin fiskal 2021.

Të dhënat dhe analitika (D&A) e auditimit

Auditimi i KPMG-së, i fuqizuar nga D&A:

- Rrit cilësinë e auditimit; duke siguruar një kuptim më të thellë të popullatës së të dhënave, duke u fokusuar në transaksionet me rrezik më të lart;
- Është i sigurtë; duke kufizuar qasjen në të dhëna si jashtë ashtu edhe brenda mjediseve të kpmg-së; dhe
- Është transparent; duke lehtësuar analizën e detajuar për të zbuluar arsyet që ndodhen pas dhe shkaqet rrënjësore të anomalive dhe për të siguruar dukshmëri më të madhe në transaksionet dhe zonat në përpunim me rrezik më të madh.

Mjetet D&A dhe proceduratjanë të ndërtuara mbi parimet dhe standardet profesionale që i nënshtrohen një auditimi dhe nuk lehtësojnë auditorët nga përgjegjësitë e tyre.

### 3.6.2 Pavarësia, integriteti, etika dhe objektiviteti

Pavarësia e auditorit është “gur themeli” i standardeve profesionale ndërkombëtare dhe kërkesave rregullatorë.

KPMG International ka detajuar politikat dhe procedurat e pavarësisë, duke përfshirë kërkesat e Kodit të Etikës IESBA. Këto janë të përcaktuara në Manualin Global të Menaxhimit të Rrezikut dhe Cilësisë (GO&RMM) të KPMG-së. Mjete të automatizuar lehtësojnë përputhjen me këto kërkesa.

Këto politika plotësohen nga procese të tjera për të siguruar përputhje me standardet e vendosura nga Instituti i Ekspertëve Kontabël në Shqipëri (IEKA) dhe Bordi dhe nga autoritetet e tjera rregullatore. Këto politika dhe procese mbulojnë fusha të tilla si pavarësinë e shoqërisë (që mbulon, për shembull, thesarin dhe funksionet e prokurimit), pavarësinë personale, marrëdhënien financiare të shoqërisë, marrëdhëniet e pas-punësimit, zëvendësimin e partnerit dhe miratimin e shërbimeve audituese dhe jo-audituese.

KPMG International ka një partner përgjegjës për Grupin e Pavarësisë Globale i cili mbështetet nga një ekip bërthamë specialistësh për të siguruar rritjen e zbatimit të politikave, procedurave dhe mjeteve të pavarura dhe konsistente në çdo shoqëri anëtare KPMG, dhe se ekzistojnë mjetet e duhura për të ndihmuar personelin e tyre të veprojnë në përputhje me këto kërkesa.

KPMG Albania ka emëruar një Partner për Etikën dhe Pavarësinë (EIP) i cili mbështetet nga një ekip specialistësh nëpërmjet të cilëve sigurohet zhvillimi i politikave dhe proceseve të forta dhe të qëndrueshme të pavarësisë në KPMG Albania.

Ndryshimet në politikat e etikës dhe pavarësisë të KPMG International, gjatë vitit, përfshihen në komunikimet e rregullta për rrezikun dhe cilësinë. Shoqëritë anëtare janë të detyruara të zbatojnë ndryshimet siç specifikohet në njoftimet me postë elektronike, dhe kjo kontrollohet përmes programeve të brendshme të monitorimit të përshkruara në seksionin 3.10.1, Programet e monitorimit të brendshëm dhe pajtueshmërisë.

Personeli i KPMG Albania është i detyruar të këshillohet me Partnerin për Etikën e Pavarësinë për çështje të përcaktuara në Manualin Global të Menaxhimit të Rrezikut dhe Cilësisë. Këshillimet mund të kërkohen edhe me Grupin e Pavarësisë Globale, në varësi të fakteve dhe rrethanave.

### **Pavarësia financiare personale**

Politikat e KPMG International kërkojnë që shoqëritë anëtare të KPMG-së dhe profesionistët e saj të jenë të lirë nga interesa të ndaluara financiare dhe

marrëdhënie të ndaluara me klientët e auditimit të shoqërive anëtare të KPMG-së, administrimin e tyre, drejtorët dhe pronarët e rëndësishëm. Politikat gjithashtu shtrijnë kufizimet e Kodit të Etikës të IESBA-s mbi pronësinë e letrave me vlerë të klientit të auditimit për çdo partner të shoqërisë anëtare të KPMG në lidhje me çdo klient të auditimit të çdo shoqëri anëtare.

Profesionistët e KPMG Albania janë përgjegjës për kryerjen e hetimeve të duhura dhe marrjen e masave të tjera të përshtatshme në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar që nuk kanë marrëdhënie financiare, biznesi apo interesa familjare të cilat ndikojnë në të qenit i pavarur.

Ashtu si shoqëritë e tjera anëtare të KPMG, ne përdorim një sistem elektronik të pajtueshmërisë për pavarësinë (KICS) për të ndihmuar stafin tonë të jenë në përputhje me politikat për pavarësinë e investimeve personale. Ky sistem përmban një inventar të investimeve në dispozicion të publikut.

Partnerët, personeli në nivel menaxherial ose më lartë që përballen me klientë, është i detyruar të përdori sistemin KICS para se të hyjë në një investim për të identifikuar nëse lejohen për ta bërë këtë. Prej tyre kërkohet gjithashtu që të regjistrojnë në sistem të gjitha investimet e tyre, dhe më pas sistemi dërgon njoftim nëse në një të ardhme ndonjë nga këto këto investime bëhen të kufizuara. Nga investimet e reja të kufizuara duhet të hiqet dorë brenda pesë ditësh pune nga marrja e njoftimit. Ne monitorojmë përputhshmërinë e partnerëve dhe menaxherëve me këtë kërkesë si pjesë e programit tonë për përpunueshmërinë e auditimeve të një numri të zgjedhur profesionistësh.

### **Marrëdhëniet e punësimit**

Çdo profesionist që ofron shërbime për një klient të auditimit, pavarësisht nga funksioni është i detyruar të njoftojë Partnerin tonë për Etikën dhe Pavarësinë në qoftë se ata kanë për qëllim të hyjnë në negociata për punësim me atë klient të auditimit. Për partnerët, kjo kërkesë shtrihet për çdo klient të auditimit të çdo shoqërie anëtare KPMG që është një entitet me interes publik.

Ish-anëtarët e grupit të auditimit ose ish-partnerët e një shoqërie anëtare janë të ndaluar ti bashkohen një klienti të auditimit në role të caktuara, vetëm nëse ata kanë hequr dorë nga të gjitha lidhjet e rëndësishme me KPMG Albania, duke përfshirë pagesat të cilat nuk janë fikse dhe të përcaktuara dhe/ose do të ishin materiale për KPMG Albania dhe



kanë ndaluar së marri pjesë në aktivitetet e biznesit apo veprimtari profesionale të KPMG Albania.

Partnerët kryesore të auditimit dhe anëtarët e grupit të drejtimin për një klient të auditimit që është një entitet me interes publik janë objekt i kufizimeve kohore (të referuara si periudha "cooling-off") të cilat i përjashtojnë ata nga marrja e disa roleve të caktuara nga klienti deri në kalimin e një periudhë të caktuar kohore.

Ne komunikojmë dhe monitorojmë kërkesat në lidhje me punësimin e profesionistëve të KPMG Albania nga klientët e auditimit.

### **Pavarësia financiare e shoqërisë**

Shoqëritë anëtare të KPMG-së gjithashtu duhet të mos kenë interesa dhe marrëdhënie të ndaluara me klientët e auditimit, menaxherët, drejtorët dhe pronarët e tyre të rëndësishëm.

Njëlloj si shoqëritë e tjera anëtare të KPMG-së, KPMG Albania përdor "KICS" për të regjistruar investimet e saj, në entitet e huaja të listuara në Komisionin e Shkëmbimit të letrave me vlerë (SEC) (përfshirë fondet), shoqëritë dhe fondet e listuara në nivel lokal, investimet direkte dhe indirekte materiale të mbajtura në skemat e pensione, dhe përfitimeve të punonjësve (duke përfshirë entitetet jo-publike dhe fondet).

Përveç kësaj, KPMG Albania është e detyruar për të regjistruar në sistem të gjitha marrëdhëniet e huamarrjes dhe të financimit të kapitalit, dhe kujdestaritë, trustet dhe llogaritë e brokërit që mbajnë aktivitetet e shoqërisë anëtare.

KPMG Albania konfirmon në bazë vjetore pajtueshmërinë me kërkesat për pavarësi, si pjesë e Programit të Pajtueshmërisë së Rrezikut.

### **Marrëdhëniet me biznesin dhe furnizuesit**

KPMG Albania ka rregulla dhe procedura të cilat janë krijuar të tilla që të sigurojnë që marrëdhëniet me biznesin të zhvillohen sipas kodit të etikës së IESBA, IEKA-s dhe kërkesave të Bordit. Përputhshmëria me këto rregulla dhe procedura rishikohet periodikisht.

Këto përfshijnë krijimin dhe mbajtjen e një procesi për të vlerësuar marrëveshjet e mundshme me palët të treta (për shembull bashkëpunimet e biznesit dhe marrëveshjet e përbashkëta të punës, marrëdhëniet e prokurimit dhe të marketingut dhe aktivitetet të

punëve publike) në veçanti nëse ato kanë një ndikim në pavarësinë e auditorit.

Të gjitha marrëdhëniet e ardhshme të biznesit janë përcaktuar për të vlerësuar rreziqet edhe për të identifikuar pavarësinë e mundshme të auditorit dhe çështjeve e konflikteve të interesit. Një marrëdhënie që përfshin një ofrues të shërbimit të palës së tretë që një shoqëri anëtare do të përdori për ta asistuar me angazhimin e klientit apo qëllime të tjera është vlerësuar gjithashtu për të përcaktuar nëse pala e tretë ka kompetenca për të ofruar shërbimet përkatëse. Individët që ofrojnë shërbimet janë të detyruar të konfirmojnë se ata kuptojnë dhe do të jenë në përputhje me etikën në fuqi dhe kërkesat për pavarësinë, dhe gjithashtu u kërkohet të përfundojnë trajnimin e etikës. Palët e treta që ofrojnë shërbime auditimi dhe sigurimi për klientët janë të detyruara të përfundojnë trajnimin e pavarësisë.

### **Blerjet e biznesit, pranimet dhe investimet**

Nëse KPMG Albania është duke konsideruar blerjen e një biznesi, apo investimi në të, është e detyruar të kryejë procedura të mjaftueshme "due diligence" për objektivin e ardhshëm për të identifikuar dhe adresuar problemet e mundshme në lidhje me pavarësinë dhe menaxhimin e rrezikut para përfundimit të transaksionit. Kërkesa specifike këshillimi aplikohen për të mundësuar pavarësinë dhe adresimin e çështjeve të tjera për bashkëveprimin e biznesit me KPMG Albania dhe rrjetin më të gjerë të KPMG.

### **Procesi i pastrimit të pavarësisë**

KPMG Albania ndjek procedura të veçanta për të identifikuar dhe vlerësuar kërcënimet ndaj pavarësisë në lidhje me klientët e mundshëm të auditimit që janë entitetet me interes publik; këto procedura, referuar edhe si "procesi i pastrimit të pavarësisë" duhet të përfundojnë para se të pranohet një angazhim auditimi për këto subjekte.

Një mjet për "Kontrollin e Pavarësisë së KPMG" është vënë në zbatim për të automatizuar dhe standartizuar të gjithë hapat e punës që përbëjnë procesin e pastrimit të pavarësisë. Kjo për t'i paraprirë rritjes së numrit të tenderave për auditim ku marrin pjesë shoqëritë anëtare dhe numrit të "pastrimeve" të pavarësive që duhet të plotësohen si rezultat i zëvendësimit të detyrueshëm të audituesve ligjore, në disa pjesë të botës.

### Trajnimet për pavarësinë dhe konfirmimet

Të gjithë partnerët e KPMG Albania dhe profesionistët e shërbimeve me klientin si dhe disa individë të tjerë, duhet të kryejnë trajnime lidhur me pavarësinë sipas nivelit si dhe funksionit të tyre nga momenti që bëhen pjesë e KPMG-së dhe më pas, në baza vjetore.

Personeli i ri që është i detyruar të përfundojë këtë trajnim duhet ta bëjë atë më herët se (a) tridhjetë ditë pasi i është bashkuar stafit të KPMG Albania ose (b) para se të japi çdo lloj shërbimi, apo para se të jetë anëtar i ekipit, për çdo klientët auditit përfshirë edhe ndonjë nga degët e tij.

Ne gjithashtu ofrojmë për gjithë personelin trajnim mbi Kodin Global të Sjelljes dhe etikën e sjelljes, duke përfshirë politikat anti ryshfet të KPMG-së, pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe standardet profesionale, dhe raportimin e papajtueshmërive të dyshuara apo faktike me ligjet, rregulloret, standardet profesionale, dhe politikat e KPMG-së në baza dyvjeçar. Personeli i ri është i detyruar të kryejë këtë trajnim brenda tre muajve pasi i bashkohet KPMG Albania.

Po ashtu, edhe personeli që nuk përballet me klientin por punon në departamentet e funksioneve mbështetëse, dhe që janë në nivelin e drejtuesit e më lart, gjithashtu kërkohet të kryejnë trajnimin anti ryshfet. Me pranimin e kontratës së punës, i gjithë personeli i KPMG-së është i detyruar të konfirmojë se është në përputhje me, dhe do të veprojë sipas etikës së zbatueshme, rregullave dhe politikave të pavarësisë. Pas kësaj, i gjithë personeli KPMG-së kërkohet të nënshkruajë një konfirmim vjetor ku thuhet se ata janë në përputhje me politikat e etikës dhe të pavarësisë gjatë gjithë vitit që mbulohet nga konfirmimi. Gjithashtu, personelit i kërkohet që të konfirmojë kuptimin dhe pajtueshmërinë me Kodin e Sjelljes. Ky konfirmim evidenton se të gjithë individët i kuptojnë politikat e pavarësisë së KPMG.

### Shërbimet jo-audituese

Ne kemi politika në përputhje me parimet IESBA dhe rregullat dhe ligjet e tjera lidhur me qëllimin e shërbimeve që mund të ofrohen për klientët e auditimit.

Ne duhet të krijojmë dhe mirëmbajmë një proces për të shqyrtuar dhe miratuar të gjitha shërbimet e reja dhe të modifikuara që ofrohen nga KPMG

Albania. EIP përfshihet në shqyrtimin e çështjeve të mundshme të pavarësisë, dhe Grupi i Pavarësisë Globale përfshihet në rastin e shërbimeve që do të ofrohen për klientët e auditit dhe sigurimit në më shumë se një juridiksion.

Përveç identifikimit të konflikteve të mundshme të interesit, sistemi jonë global i kontrollit të konflikteve dhe pavarësisë Sentinel, lehtëson pajtueshmërinë me këto politika. Informacione të caktuara për të gjitha angazhimet e ardhshme duke përfshirë përshkrimin e shërbimeve dhe tarifave duhet të regjistrohen në Sentinel™, si pjesë e procesit të pranimit të angazhimit.

Partnerët e angazhimit të auditimit janë të detyruar të: mbajnë strukturat e grupit për klientët që tenderohen me anë të procedurave publike dhe për klientët e tjerë të auditimit si dhe degët e tyre në Sentinel, dhe gjithashtu janë përgjegjës për identifikimin dhe vlerësimin për çdo cenim të pavarësisë që mund të lindë nga ofrimi i një shërbimi të propozuar jo-audit dhe masat mbrojtëse në dispozicion për të trajtuar këto kërcënime. Për subjektet për të cilat strukturat e grupit janë ruajtur, Sentineli u mundëson partnerëve të angazhimit të auditimit të shqyrtojnë të miratojnë, ose të refuzojnë, ndonjë shërbim të propozuar për këto subjekte në mbarë botën.

### Varësia e tarifave

Politikat e KPMG International pranojnë se në rastet kur tarifave totale të mbledhura nga klientët e audituar përbëjnë një proporcion të lartë të tarifave të gjithë shoqërisë anëtare, atëherë interesa vetjake mund të dominojnë. Në mënyrë të veçantë, këto politika kërkojnë që në rastet kur tarifa totale për një klient me interes publik lidhet me subjekte dhe përfaqëson 10% të tarifave totale të marra nga një shoqëri e jona në rrjet për dy vjet radhazi:

- Diçka e tillë u parashtrohet dhe atyre që janë të ngarkuar në qeverisjen e e shoqërisë kliente e së auditimit.
- Një partner i lartë nga një shoqëri tjetër anëtare në rrjet caktohet si kontrollues EQCR për këtë angazhim.

Nuk ka asnjë klient auditit që llogarit më shumë se 10 për qind të totalit të tarifave të marra nga KPMG Albania gjatë dy viteve të fundit.

### Shmangia e konfliktit të interesit

Konfliktet e interesit mund të lindin në situata ku personeli i KPMG Albania ka një lidhje personale me klientin e cila mund të ndërhyjë, ose të perceptohet se mund të ndërhyjë, në aftësinë e tyre për të qëndruar objektiv, ose kur ata personalisht kanë informacion konfidencial në lidhje me një palë tjetër për një transaksion. Në këto situata, është e nevojshme këshillimi me Partnerin e Menaxhimit të Rrezikut ose Partnerin e Etikës dhe Pavarësisë.

Të gjitha shoqëritë anëtare KPMG dhe personeli i tyre janë përgjegjës për identifikimin dhe administrimin e konflikteve të interesit, të cilat janë rrethana apo situata që mund të perceptohen nga një vëzhgues plotësisht i informuar dhe i arsyeshëm, që të kenë ndikim në një shoqëri anëtare apo personelin e saj në aftësinë e tyre për të qenë objektivë ose për të dhënë një gjykim të drejtë.

Çdo çështje e mundshme konflikti që ngre pika të rëndësishme të parimit për ne, drejtohet për zgjidhje tek Partneri i Menaxhimit të Rrezikut; në raste të vështira mund të mbledhet një panel i përbërë nga partnerë për të zgjidhur çështjen.

Sentinel është mjet i cili përdoret nga të gjitha shoqëritë anëtare KPMG për identifikimin e konflikteve të mundshme, në mënyrë që këto të mund të trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe profesionale.

KPMG Albania ka burime të menaxhimit të rrezikut ('Resolvers') të cilët janë përgjegjës për rishikimin e konflikteve të mundshme të identifikuar dhe për të punuar me shoqëritë anëtare të caktuara për të zgjidhur konfliktin, rezultati i të cilit duhet të dokumentohet. Mund të jetë e nevojshme që konfliktet e interesit të zgjidhen nëpërmjet procedurave specifike me qëllim që të ruhet konfidencialiteti i të gjithë klientëve. Të tilla procedura përfshijnë për shembull ndarjen formale të ekipeve që i shërbejnë klientëve të ndryshëm dhe monitorimin e kësaj ndarjeje.

Në rastet kur marrëveshja nuk arrihet për ti dhënë zgjidhje konfliktit, ekziston një procedurë përshkallëzimi. Në rastet kur konflikti nuk mund të zgjidhet, angazhimi nuk pranohet ose përfundohet.

### Shkeljet e politikave të pavarësisë

I gjithë personeli i KPMG Albania është i detyruar të raportojë çdo shkelje të pavarësisë menjëherë sa vihet në dijeni për të.

Në rast të dështimit për të përmbushur politikat tona të pavarësisë të shoqërisë, nëse identifikohen në rishikimin e pajtueshmërisë, të vetë-shpallur ose ndryshe, profesionistët janë subjekt i një politike disiplinore të pavarësisë.

KPMG Albania ka një politikë të dokumentuar disiplinore në lidhje me shkeljet e politikave të pavarësisë.

Politika disiplinore u komunikohet të gjithë profesionistëve dhe vlen për të gjitha shkeljet e rregullave të pavarësisë, duke përfshirë sanksione në rritje që reflektojnë seriozitetin për çdo shkelje. Çdo shkelje e rregulloreve të auditimit të pavarësisë raportohet tek personat e ngarkuar për qeverisjen e klientëve të auditimit, sipas dakortësismit me ta por së paku në baza vjetore.

Çështjet që dalin faktohen në promovim dhe vendimet e kompensimit dhe, në rastin e udhëheqësve dhe menaxherëve të angazhimit, pasqyrohen në parametrat e tyre individuale të cilësive dhe rrezikut.

### Pajtueshmëria me legjislacionin, rregulloret dhe anti-ryshfeti e korrupsion

Pajtueshmëria me ligjet, rregulloret dhe standardet është një aspekt kryesor për të gjithë personelin e KPMG Albania. Në veçanti, ne kemi zero tolerancë ndaj ryshfetit dhe korrupsionit. Ne ndalojmë përfshirjen në çdo lloj ryshfeti edhe në qoftë se një sjellje e tillë është e ligjshme apo e lejuar sipas ligjit të aplikueshëm ose praktikave vendore. Ne gjithashtu nuk tolerojmë ryshfete nga palët e treta, duke përfshirë edhe nga klientët tanë, furnitorët apo zyrtarët publikë.

Informacione të mëtejshme për politikat kundër ryshfetit dhe korrupsionit të KPMG International mund të gjenden në faqen e [anti-ryshfetit dhe korrupsionit](#).

### Zëvendësimi i Partnereve të dhe i shoqërisë së Auditimit

#### Zëvendësimi i Partnereve

Politikat e zëvendësimit të partnereve të KPMG International janë në përputhje me Kodin e Etikës IESBA dhe kërkojnë që shoqëritë anëtare të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e rrepta lokale të zbatueshme për zëvendësimin.

Partnerët e KPMG Albania dhe drejtuesit e angazhimeve janë subjekt i zëvendësimit periodik

të përgjegjësive të tyre për klientët e auditimit sipas ligjeve në fuqi, rregulloreve, rregullave të pavarësi dhe politikës të KPMG International. Këto kufizime vendosin limite në numrin e viteve të njëpasnjëshme që partnerët në role të caktuara mund të ofrojnë shërbime auditimi për një klient, e ndjekur nga një periudhë 'time-out', gjatë së cilës këta partnerë nuk mund të marrin pjesë në auditim, të ofrojnë kontroll të cilësisë të auditimit, të konsultohen me ekipin e angazhimit ose të klientit në lidhje me çështjet teknike ose industri specifike apo në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojnë në rezultatin e auditimit.

KPMG Albanian monitoron zëvendësimin e drejtuesëve të angazhimit të auditimit (dhe roleve të tjera kryesore, të tilla si partneri kyç i Auditimit dhe rishikuesin EQC, ku kërkohet zëvendësim) dhe zhvillojmë një plan tranzicioni për të mundësuar ndarjen e partnerëve dhe/ose drejtuesit e angazhimeve me kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar një cilësi të qëndrueshme për shërbimet ndaj klientëve. Monitorimi i zëvendësimit të partnerëve i nënshtrohet testimit të përputhshmërisë.

### Zëvendësimi i Shoqërisë së Auditimit

Sipas Ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit 52/2014 "Për Veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Rregullores nr.2, datë 17.01.2013 të Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e Riskut në aktivitetin e institucioneve financiare jo-bankare", dhe Rregullores nr.89, datë 27.06.2017 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar", KPMG Albania i kërkohet të jetë auditues për njësitë ekonomike me interes publik, financiare (banka dhe subjekte financiare jo-bankar) dhe sigurimi (shoqëri sigurimi, fonde pensioni vullnetar dhe sipërmarrje të investimeve kolektive) për një periudhë maksimale përkatësisht shtatë dhe katër, dhe të mos jetë auditues për klient të tillë për dy vite pas përfundimit të auditimit të fundit (referuar si "periudha e pauze"). KPMG Albania ka proceset e veta për të ndjekur dhe drejtuar zëvendësimin e shoqërisë së auditimit.

## 3.7 Rekrutimi, zhvillimi dhe përcaktimi i personelit të kualifikuar

Një nga pikat kyçe të cilësisë sonë është përcaktimi i individëve me kualifikimin e duhur, eksperiencën dhe pasionin e qëllimin e duhur për të ofruar shërbimin e auditimit cilësor. Kjo kërkon fokusim në rekrutimin, zhvillimin, promovimin e personelit, zhvillime të kapaciteteve të qëndrueshme. Sjelljet globale të KPMG që lidhen me vlerat e KPMG-së, janë të ndërtuara për të ndihmuar artikullimin e nevojshëm për sukses si individualisht ashtu edhe kolektivisht. Një nga sjelljet globale të KPMG është "Ofrimi i Cilësisë".

### 3.7.1. Rekrutimi

KPMG Albania përpiqet të jetë një punëdhënës i zgjedhur duke krijuar një mjedis ku njerëzit tanë mund të përmbushin potencialin e tyre dhe të ndjehen krenarë dhe të motivuar për të dhënë më të mirën e tyre.

Strategjitë tona të rekrutimit përqendrohen në tërheqjen e talenteve nga një burim i gjerë talentesh, duke përfshirë bashkëpunimin me universitetet

Të gjithë kandidatët për pozicionet profesionale në shoqërinë tonë, dorëzojnë një aplikim dhe përzgjidhen me një sërë procedurash që përfshijnë: rishikim të detajuar CV, intervista, testim dhe kontroll kualifikimesh/referencash.

Kur individët rekrutohen për pozicione më të larta, zhvillohet një diskutim zyrtar i pavarësisë me ta nga Partneri i Etikës dhe Pavarësisë ose një delegat. KPMG Albania nuk pranon asnjë informacion konfidencial që i përket ish-shoqërisë/ punëdhënësit të kandidatit.

Procesi i punësimit të Partnerëve është rigoroz dhe i plotë, duke përfshirë anëtarët e duhur të lidhshëm. Kriteret tona për rekrutimin e Partnerëve janë në përputhje me angazhimin tonë për profesionalizëm dhe integritet, cilësi, dhe të qenët një punëdhënës i zgjedhur. Këto janë të lidhura fort me aftësitë e sjelljes së KPMG dhe bazohen në parime të qëndrueshme.

### 3.7.2 Zhvillimi individual

Është e nevojshme që të gjithë individët të kenë aftësitë e nevojshme për të kryer punë cilësore përpos të qenit të aftë teknikisht ([shiko seksionin 3.8.1 Politika e të mësuarit gjatë gjithë jetës](#)).

KPMG po fillon një proces të ri të Zhvillimit të Performancës i cili do të aplikohet për të gjitha shoqëritë anëtare i quajtur 'Çdokush është Udheheqës', ku përcaktimi i objektivave duhet të vendoset dhe të rishikohet rregullisht gjatë gjithë vitit. Kompetencat e drejtimit do të përfshijnë 'orientimin drejt cilësisë', 'krijimin i një mjedisi etik' dhe 'marrjen e vendimeve të shëndosha'. Një listë objektivash vihet në dispozicion të stafit për të përacaktuar objektivat që duan të vendosin, një kategori objektivash të fokusuara posaçërisht në lidhje me cilësinë.

Një kulturë e përmirësimit të vazhdueshëm inkurajohet të nxisë reagimet pozitive dhe Zhvilluese nga kolegët e rinj dhe ata me eksperiencë, si dhe nga kolegët në të njëjtin nivel. Në qasjen tonë të zhvillimit të performancës mund të kërkohet dhe merret opinion nëpërmjet dy mekanizmave, vlerësimeve joformale, të cilat duhet të jenë të rregullta dhe në pronësi të individit për zhvillimin dhe rritjen e tyre dhe vlerësime formale përmes një formulari për shqyrtimin e angazhimit. Forma e rishikimit të angazhimit kërkon në mënyrë specifike kërkesa për vlerësime mbi cilësinë dhe kërkohet në baza tremujore, si dhe kontribuon në vlerësimet e performancës.

Partnerët dhe personeli i caktuar, gjithashtu kërkohen të vlerësohen për sa i përket cilësisë dhe pajtueshmërisë. Auditimi i KPMG monitoron incidentet në cilësi dhe mirëmban parametrat e cilësisë dhe pajtueshmërisë për qëllimet e detyrave të partnerëve dhe gjithashtu për qëllime të vlerësimit, promovimit dhe shpërblimit.

Në audit, ne ofrojmë mundësi që profesionistët të zhvillojnë aftësitë, sjelljet dhe cilësitë personale që janë baza e një karriere të suksesshme në audit. Kurse të ndryshme mundësohen me qëllim rritjen e efektivitetit dhe zhvillimin e aftësive teknike, drejtuese dhe rritjen e efikasitetit. Personeli i KPMG Albania zhvillohet më tej për performancë të lartë duke e udhëhequr, ndjekur vazhdimisht në punë, duke i shtuar përgjegjësitë dhe duke i ofruar mundësi zhvendosje në mbarë botën.

Talenti dhe zhvillimi janë në krye të veprimtarisë të stafit tonë dhe janë një investim i rëndësishëm i

kohës, parave dhe burimeve të tjera për të ndërtuar aftësitë profesionale, aftësive drejtuese dhe ekspertizës teknike.

I gjithë stafi inkurajohet të mendojë për karrierën e tij dhe nevojat e zhvillimit personal nëpërmjet bisedave të rregullta të performancës me komente dhe mbështetje të vazhdueshme. Për të mbështetur karrierën dhe zhvillimin profesional ka një shumëllojshmëri programesh bazë që mbulojnë aftësitë dhe sjelljet që ofrojnë përmirësim të performancës dhe sigurojnë që individët të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Qendrat e zhvillimit dhe mjetet e reagimit mundësojnë që KPMG Albania të identifikojë personat me nivel të lartë të performancës të cilët gjithashtu kanë aftësi për të marrë role më të larta apo më të ndërlikuara. Në gjithashtu kemi programe afatgjata zhvillimi në mënyrë që të mbështesim rrugën e karrierës së stafit më të ri drejt nivelit menaxherial, si dhe për stafin që është identifikuar dhe në prag promovimi për rolet drejtuese dhe si Partnerë. Duke ditur se një pjesë e stafit tonë nuk mundën të marrin pjesë gjithnjë në kurse trajnimi vetë personalisht, për të plotësuar përzierjen ndërmjet arsimimit, bashkëpunimit dhe përvojës, dhe për të siguruar trajnimin në kohën e duhur në një qasje fleksibile dhe interaktive, ne u mundësojmë trajnimin online dhe klasave virtuale.

Në lidhje me Auditimin ne ofrojmë mundësi të veçanta nga diplomimi në nivele të larta për profesionistët për të zhvilluar dhe për të ruajtur aftësitë, sjelljet dhe cilësitë personale që formojnë themelet e një karriere të suksesshme në auditim. Kurset janë në dispozicion për të rritur efikasitetin personal dhe zhvillimin teknik, udhëheqjen dhe aftësitë e biznesit.

### 3.7.3 Përfshirja dhe Programet e Diversitetit

KPMG Albania punon shumë për të nxitur një kulturë gjithëpërfshirëse. Duke qenë gjithëpërfshirës na jepet mundësia që të bashkojmë ekipe të suksesshme me larmishmëri më të gjerë të aftësive, përvojave dhe perspektivave.

Ekipe të drejtimit tonë dhe të menaxhimit gjithashtu duhet të reflektojnë diversitetin brenda shoqërisë sonë dhe diversitetin e klientëve tanë. Ne besojmë se strategjia e KPMG International për Përfshirjen dhe Diversitetin Global siguron kornizën për të ndërmarrë veprimet që janë të nevojshme për të promovuar drejtimin gjithëpërfshirës në KPMG Albania dhe në rrjetin KPMG.

Për më shumë rreth Përfshirjes dhe Diversitetit në KPMG mund të lexoni [këtu](#).

### 3.7.4 Performanca dhe kompensimi

#### Procesi i vlerësimit duke përfshirë parametrat e cilësisë dhe përputhshmërisë

Të gjithë profesionistët e KPMG Albania përfshirë këtu dhe partnerët, u nënshtrohen një procesi vjetor të vendosjes së qëllimeve dhe vlerësimit të performancës. Çdo profesionist vlerësohet mbi bazën e përmbushjes së qëllimeve që ka vendosur, shfaqjen e aftësive dhe sjelljeve të duhura në përshtatje me kompetencat e drejtimit si dhe aftësive teknike dhe njohjes së tregut.

Ne inkurajojmë kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm për të nxitur reagime, formale dhe jo formale, nga kolegët e rinj dhe të vjetër. Reagimi i mbledhur përbën një pjesë integrale të rishikimeve të performancës.

KPMG Albania monitoron incidentet në lidhje me cilësinë dhe pajtueshmërinë dhe për të ruajtur parametrat e cilësisë për qëllime të detyrave të drejtorëve dhe menaxherëve si dhe për qëllime të vlerësimit të partnerit, promovimit dhe shpërblimit.

Politika e KPMG Albania ndalon partnerët e auditimit të vlerësohen ose paguhen në bazë të suksesit të tyre duke ofruar shërbime jo-sigurimi për të klientët e auditit.

Çdo vit, partnerëve u kërkohet gjithashtu të dakortësojnë objektivat për vitin e ardhshëm të cilat janë specifike për rolin e tyre individual. Ata e bëjnë këtë duke përdorur një formë përcaktimi të qëllimeve që shënon objektivat e tyre dhe performancën e tyre kundrejt atyre objektiveve në fund të vitit, duke përfshirë performancën e tyre në lidhje me çështjet e cilësisë dhe rrezikut (që sigurisht është e rëndësishme për të gjitha shërbimet tona, por absolutisht kritike për auditimin ligjor). Për sa i përket personelit, si pjesë e aktivitetit të zhvillimit të performancës në fund të vitit partnerët tanë diskutojnë arritjen e qëllimeve të dakortësuar, përparësitë dhe fushat e zhvillimit me fokus të veçantë në shpërndarjen dhe zhvillimin personal të attributeve të partnerit. Atyre u kërkohet të ofrojnë dëshmi objektive për ta demonstruar këtë, e cila përfshin cilësinë individuale, etikën dhe parametrat e pajtueshmërisë.

Këto masa të standardizuara (të cilat u jepen të gjithë udhëheqësve të angazhimit dhe menaxherëve)

janë një nga burimet e procesit të vlerësimit vjetor. Metrika e cilësisë, etikës dhe përputhshmërisë përfshin një numër parametrash, të tilla si rezultatet e rishikimeve të jashtme rregullative, përfundimin në kohë të trajnimit dhe rezultatin e programeve të monitorimit të brendshëm. Individët kanë marrë metrikën (të cilat janë ose të kuqe, ose protokalli, ose jeshile) në lidhje me secilën prej Cilësisë, Etikës dhe Pajtueshmërisë.

Veprimi i ndërmarrë në lidhje me cilindo partner që rezultoi me portokalli dhe të kuqe ('e pafavorshme') metrika varet nga shkaku i metrikës së kundërt në fillim. Gama e veprimeve që mund të merren përfshin përmirësimin e mangësisë fillestare që shkakton ngritjen e metrikës së pafavorshme, trajnimeve përmirësuese, këshillimin një-me-një me udhëheqjen funksionale dhe/ose Partnerët e Cilësisë & Rrezikut për çështjen që del ose, përfundimisht pezullimin e të drejtave të nënshkrimit. Parametrat negative, në përgjithësi, rezultojnë në-uljen e kompensimit të përgjithshëm të paguar për Partnerin në fjalë.

#### Shpërblimi

Ne kemi politika kompensimi dhe promovimi që janë të qarta, të thjeshta dhe të lidhura me procesin e rishikimit të performancës, i cili, për partnerët, përfshin arritjen e cilësisë kyçe të auditimit dhe matjes së pajtueshmërisë. Kjo i ndihmon partnerët dhe punonjësit tanë të dinë se çfarë pritet prej tyre, dhe çfarë mund të presin të marrin në këmbim.

Vendimet e shpërblimit bazohen në rishikim e performancës individuale dhe organizative (shoqëria anëtare). Masa në të cilën njerëzit tanë ndjejnë se performanca e tyre është reflektuar në shpërblimin e tyre matet nëpërmjet Anketimit Global të Njerëzve, me planet e veprimit të zhvilluara në përputhje me rrethanat.

#### Promovimi

Rezultatet e vlerësimeve të performancës ndikojnë drejtpërdrejt në promovimin dhe shpërblimin e partnerëve dhe stafit dhe, në disa raste, lidhjen e tyre të vazhdueshme me KPMG.

### 3.7.5 Pranimi i Partnerëve

Procesi i KPMG Albania për pranimin e partnerëve është mjaft rigoroz dhe përshin në vendim-marrje nivele të larta drejtuese. Kriteret tona për tu bërë partner i KPMG-së janë konsistente

me përkushtimin tonë ndaj profesionalizmit dhe integritetit, cilësisë dhe të qenit një punëdhënës i zgjedhur. Këto shkojnë në të njëjtin drejtim me mënyrën e sjelljes së KPMG-së dhe bazohen në parime të qëndrueshme. Rekomandimet për pranim të partnerëve në KPMG Albania duhet të miratohen nga Bordi i KPMG në Europën Qendrore e Lindore.

### 3.7.6 Shpërndarja e personelit në angazhime

KPMG Albania ka procedura përzgjedhjeje si për partnerët dhe drejtuesit e angazhimeve, ashtu dhe për individët e tjerë në ekip duke u bazuar në vlerësimin e aftësive të tyre, eksperiencën në llojin e industrisë dhe natyrën e angazhimit.

Drejtuesit e funksioneve janë përgjegjës për procesin e emërimit të partnerit ose drejtuesve të angazhimeve. Pikat kryesore që merren në konsideratë janë eksperiencia, akreditimet dhe mundësitë, duke u bazuar në rishikimin e portofolit vjetor, për ta zbatuar angazhimin duke marrë në konsideratë madhësinë, kompleksitetin, profilin e rrezikut të angazhimit si dhe llojin e suportit të ofruar (p.sh përbërja e ekipit të angazhimit dhe përfshirja e specialistëve).

Partnerët dhe drejtuesit e angazhimeve në audit duhet të jenë të kënaqur që ekipet në një angazhim të kenë trajnimin dhe aftësitë, duke përfshirë dhe kohën të performojnë në angazhime bazuar në KAM, standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore. Kjo mund të përfshijë edhe specialistë të ndryshëm nga shoqëria jonë apo nga shoqëri të tjera anëtare të KPMG-së.

Si një kontroll shtesë Drejtuesi i Auditimit kryen një shqyrtim vjetor të portofolit të gjithë partnerëve dhe drejtuesve tanë të angazhimeve të auditimit. Qëllimi i këtij shqyrtimi të portofolit është që të shikojmë kompleksitetin dhe rrezikun e çdo auditimi dhe pastaj të marrim në konsideratë nëse partneri ose drejtuesi i caktuar i angazhimit ka kohën dhe mbështetjen e duhur për të mundësuar partnerit të angazhimit kryerjen e një kontrolli të cilësisë së lartë për çdo klient në portofolin e tij.

Në konsiderimin e aftësive dhe kompetencave të duhura të individëve në ekip, partneri ose drejtuesi i angazhimit u referohet pikave në vijim:

- Të kuptuarit, dhe përvoja praktike me, angazhimet e auditimit të një natyre dhe kompleksitet të ngjashëm përmes trajnimit dhe pjesëmarrjes së duhur

- Të kuptuarit e standardeve profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullative
- Aftësive të duhura teknike përfshirë këtu si ato të teknologjisë së informacionit edhe ato në fusha specifike të kontabilitetit apo auditimit
- Njohurive mbi industrinë ku klienti ushtron aktivitetin
- Aftësive për të aplikuar gjykim profesional dhe
- Njohurive të politikave dhe procedurave për kontrollin e cilësisë
- Rezultateve të Kontrollit të Cilësisë dhe rezultatet e inspektimeve nga rregullatorët

### 3.7.7 Këndvështrimi i punonjësve tanë – Anketimi Global i Njerëzve

Çdo dy vjet KPMG Albania fton të gjithë stafin për të marrë pjesë në një Anketë Globale të Njerëzve (GPS) për të ndarë perceptimin e tyre në lidhje me eksperiencën e punës në KPMG. Anketa mat qëndrimet e stafit tonë dhe siguron Indeks të përgjithshëm të Angazhimit të Punonjësve (EEI) si dhe njohuri në fushat që drejtojnë angazhimin, të cilat mund të jenë pikat e forta ose mundësitë. Sondazhi gjithashtu identifikon mundësitë për të forcuar ato nivele të angazhimit. Rezultatet mund të analizohen sipas zonës funksionale ose gjeografike, klasës, rolit, gjinisë për të dhënë njohuri shtesë. Pasqyrë e mëtejshme jepet për mënyrën se si po i afrohem kategorive të njohura që ndikojnë angazhimin e punonjësve.

Sondazhi gjithashtu siguron në mënyrë specifike për drejtimin e KPMG-së dhe drejtimin global rezultatet në lidhje me cilësinë e auditimit, ngritjen e vlerave të KPMG-së mbi qëndrimet e punonjësve dhe partnerëve ndaj cilësisë, drejtimit dhe tonin në krye.

KPMG Albania merr pjesë në GPS, monitoron rezultatet dhe merr masat e duhura për të komunikuar dhe për t'iu përgjigjur gjetjeve të sondazhit. Kjo përfshin monitorimin e rezultateve të GPS duke përfshirë ato që lidhen me cilësinë e auditimit dhe "tone at the top", dhe angazhimi i punonjësve përmes Indeksit të angazhimit të punonjësve.

Rezultatet e GPS janë gjithashtu të grumbulluara për rrjetin e KPMG dhe janë paraqitur në Bordin Global çdo vit dhe bihet dakord për veprimet që duhet të ndërmerren

### 3.8 Përkushtim ndaj ekselencës teknike dhe shërbimit cilësor

Ne u sigurojmë të gjithë individëve trajnimet teknike dhe mbështetjen e nevojshme. Kjo përfshin dhe aksesimin e specialistëve dhe Departamentin e Praktikës Profesionale qoftë për aksesimin e burimeve të ndryshme apo për konsultim të cilat përbëhen nga profesionist të lartë me eksperiencë të madhe në auditim, raportim dhe administrimin e rreziku. Kur burimi i duhur nuk është i disponueshëm në KPMG Albania, qasja i ofrohet një rrjeti profesionistësh të kualifikuar të KPMG-së në shoqëritë e tjera anëtare të KPMG-së.

Në të njëjtën kohë ne përdorim politikat tona të akreditimit të auditimit dhe licencimit për t'u kërkuar profesionistëve që të kenë njohuritë dhe përvojën e duhur për angazhimet e tyre të caktuara.

#### 3.8.1 Politika e të mësuarit gjatë gjithë jetës

Përveç zhvillimit personal siç diskutohet në seksionin më sipër politika jonë e të mësuarit gjatë gjithë jetës mbështetet nga politika që u kërkojnë të gjithë profesionistëve të kenë aftësitë teknike për t'iu përmbajtur kërkesave rregullatore dhe atyre për zhvillimin profesional.

#### Trajnimi Formal

Prioritetet e trajnimit vjetor për zhvillimin dhe shpërndarjen identifikohen nga grupet drejtuese të Mësimit dhe Zhvillimit të Auditimit në nivel global, rajonal dhe aty ku është e mundur, në nivelin e KPMG Albania. Trajnimi zhvillohet duke përdorur një përzierje të klasës, mësimi elektronik dixhital dhe mbështetjes së performancës për të ndihmuar auditorët në punë. Ekipet e Mësimit dhe Zhvillimit të Auditimit punojnë me ekspertët e lëndëve dhe udhëheqësit nga GSC, Grupi i Standardeve Ndërkombëtare dhe Departamenti i Praktikës Profesionale (DPP), sipas rastit, për të siguruar që trajnimi është i cilësisë më të lartë, i duhur për performancën në punë dhe ofrohet në kohë.

#### Të mësuarit dhe trajnimi në vendin e punës

Të mësuarit nuk është i kufizuar në klasë përvoja të pasura të mësimit janë në dispozicion kur shihen e nevojshme nëpërmjet trajnimit dhe të mësuarit në kohë, të gjitha në dispozicion me një klik dhe të radhitura sipas profileve specifike të roleve në punë dhe metoda të mësuarit. Të gjitha klasat e kurseve

janë të përforcuara me mbështetjen e duhur të performancës për të ndihmuar auditorët në punë.

Në lidhje me auditimin, KPMG Albania:

- Do të vendosë një shumëllojshmëri zgjedhjesh të të mësuarit që janë projektuar për të përforcuar vlerat e KPMG-së dhe mundësojnë profesionistët tanë të marrin bazat e drejta, dhe të zhvillojnë aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për të dhënë gjykime, dhe të aplikojnë skepticizmin profesional që rrit cilësinë dhe vlerën e auditimit
- Do të ofrojë trajnime dhe klasa virtuale, mjete mbështetëse të performancës, udhëzime dhe të mësuarit në-kohë, janë në dispozicion për gjykimin e temave të auditimit - kjo është përdorur nga ekipet e auditimit dhe përmbajtja e tyre është ngulitur në të gjitha zgjidhjet e të mësuarit të auditimit
- Ka zhvilluar gjithashtu mjete profesionale për gjykim, të dizajnuara për të përforcuar rëndësinë e pavarësisë dhe objektivitetit, dhe për të ndihmuar ekipet e angazhimit në demonstrimin e skepticizmit profesional.
- Do të ofrojë kurse për të rritur efektivitetin personal dhe zhvillimin aftësive drejtuese të biznesit. Stafi jonë është zhvilluar më tej për performancë të lartë me anë të trajnimit dhe mentorimit në punë, detyrave dhe mundësive për lëvizje profesionale ne rang vendi dhe jashtë vendit.
- Udhëzime të trajnimeve janë në dispozicion për tema gjykuese të auditimit – këto përdoren nga ekipet e auditimit dhe janë të mishëruara në zgjidhje të mësuarit të auditimit. Ne mbështesim një kulturë stërvitjeje gjatë gjithë KPMG për të mundësuar personelin që të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ku secili nga anëtarët e ekipit është përgjegjës për të ndërtuar kapacitetin e skuadrës, për trajnimin dhe ndarjen e eksperiencave.

#### 3.8.2 Licencimi dhe kërkesat e detyrueshme për angazhimet e SNRF

##### Licencimi

Të gjithë profesionistët e KPMG-së në Shqipëri duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e aplikueshme të licencës profesionale dhe të përmbushin kërkesat e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD) në juridiksionin ku ato praktikohen.



Janë hartuar politikat dhe procedurat për të lehtësuar kërkesat për licencim.

Ne jemi përgjegjës për t'u siguruar që audituesit profesionistë që punojnë në angazhime, të kenë njohuritë e duhura të auditimit, kontabilitetit dhe industrisë, si dhe eksperiencë në kuadrin e raportimit financiar lokal mbizotërues- SNRF.

Gjithashtu ne kemi kërkesa akreditimi për partnerët, drejtuesit dhe Rishikuesit e Kontrollit të Cilësisë së Angazhimit dhe menaxherët që punojnë në angazhime ku aplikohen Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në vendet ku SNRF nuk është kuadri dominues i raportimit financiar. Politikat e ngjashme aplikohen për angazhimet e kryera jashtë SHBA-ve për të raportuar mbi pasqyrat financiare ose informacionin financiar të përgatitur në përputhje me standartin e GAAP të SHBA dhe / ose audituar në përputhje me standardet e auditimit të SHBA, duke përfshirë raportimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit mbi Raportimin Financiar të Brendshëm (ICFR).

Këto kërkojnë që partneri, menaxheri, Rishikuesi i Kontrollit të Cilësisë (EOC), të kenë trajnime të mjaftueshme si dhe i gjithë ekipi i angazhimit të ketë eksperiencë në zhvillimin e angazhimeve ose të ketë zbatuar masat e duhura për të adresuar ndonjë mungesë në personel.

### 3.8.3 Qasje në rrjete specialistësh

Ekipet e angazhimeve në KPMG Albania kanë qasje në një rrjet të specialistëve lokalë të KPMG-së si dhe atyre në shoqëri të tjera ndërkombëtare, anëtare të KPMG-së.

Specialistët të cilët janë anëtarë të një grupi të auditimit dhe kanë përgjegjësi të përgjithshme për përfshirjen e specialistëve në një angazhim të auditimit kanë kompetencat, aftësitë dhe objektivitetin për të përmbushur në mënyrë të përshtatshme rolin e tyre. Këtyre të fundit u ofrohet trajnimi për konceptet e auditimit.

Nevoja për specialistë që do të caktohen në një angazhim të veçantë të auditimit konsiderohet si pjesë e procesit të pranimit dhe vazhdimit të angazhimit të auditimit.

### 3.8.4 Kultura e Këshillimit

KPMG inkurajon një kulturë të fortë të konsultimit që mbështet ekipet e shoqërive anëtare gjatë proceseve të tyre të vendimmarrjes dhe është një

kontribues themelor në cilësinë e auditimit. KPMG Albania promovon kulturën ku Këshillimi njihet si një forcë dhe inkurajon personelin për t'u konsultuar për çështje të vështira ose të diskutueshme.

Për të asistuar profesionistët e angazhimeve të auditimit në përcaktimin e çështjeve të vështira ose të diskutueshme, janë vendosur protokolle për këshillimin dhe dokumentimin e çështjeve domethënëse kontabël dhe të auditimit, duke përfshirë procedurat për të lehtësuar zgjidhjen e diferencave të opinionit mbi çështje të angazhimit.

Përveç kësaj, Manuali Global i Menaxhimit të Rrezikut të KPMG-së përfshin kërkesat e konsultimit të detyrueshëm kur caktohen disa çështje të tilla si shqetësimet mbi integritetin e klientit.

### Konsultimet teknike dhe burimet globale

Për KPMG Albania, funksioni i DPP është thelbësor për mbështetjen që ai i siguron Funksionit të Auditimit.

Ai siguron udhëzime teknike për profesionistët e shërbimeve ndaj klientit, në çështje të lidhura me angazhime specifike, zhvillon dhe përhap udhëzime të lidhura me tema specifike mbi çështje lokale teknike dhe profesionale që janë në zhvillim, si dhe përhap udhëzime ndërkombëtare mbi SNRF dhe ISAs.

Konsultimi me një anëtar të skuadrës në një nivel më të lartë përgjegjësie sesa secila nga palët e ndryshme, zakonisht i zgjidh diferenca të tilla. Në rrethana të veçanta, çështja mund të ngrihet përmes zinxhirit të përgjegjësisë për zgjidhje nga specialistët teknikë. Në rrethana të veçanta, një çështje mund t'i referohet Drejtuesit të Auditimit, Drejtuesit të DPP, Partnerit të Menaxhimit të Rrezikut (ose delegatëve të tjerë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme) ose në fund, partnerit të lartë kombëtar.

Auditimi dhe kontabiliteti teknik dhe mbështetja e auditimit janë në dispozicion të të gjitha shoqërive anëtare dhe profesionistëve të tyre përmes GSC dhe ISG si dhe me Grupin e Tregjeve të Kapitalit të SHBA për regjistruarit e jashtëm të SEC.

### Qendra e Shërbimeve Globale (GSC)

GSC ka për qëllim të përcjelli sukses në rrjetin global të praktikave të auditimit të KPMG-së përmes bashkëpunimit, inovacionit dhe teknologjisë. GSC zhvillon, mirëmban dhe vendos metodologjinë globale të auditimit të KPMG-së

dhe mjete të bazuara në teknologji për përdorim nga profesionistët e auditimit KPMG për kryerjen e auditimeve efektive dhe efikase. Me tre vendodhje globale, një në secilin rajon, ekipi i Auditimit të GSC përbëhet nga profesionistë me përvojë në auditim, IT, shkenca ekzakte, matematikë, statistika dhe që sjellin përvoja të ndryshme nga gjithë bota dhe mënyra inovative të të menduarit për të përmirësuar më tej aftësitë e auditimit të KPMG-së.

### Grupi i Standarteve Ndërkombëtare (ISG)

ISG punon me ekipet globale të SNRF dhe ISAs me përfaqësimin gjeografik nga e gjithë bota për të promovuar qëndrueshmërinë e interpretimit të SNRF dhe kërkesave të auditimit ndërmjet shoqërive anëtare, identifikimin e çështjeve urgjente, dhe për të zhvilluar udhëzime globale në kohën e duhur.

Hollësi të mëtejshme në lidhje me GSC e ISG dhe aktiviteteve të tyre janë në dispozicion në [Raportit të Transparencës së KPMG International](#).

### Burimi i praktikës profesionale të shoqërisë anëtare

Mbështetja përkatëse e konsultimeve për çështjet e auditimit dhe të kontabilitetit teknik u ofrohet profesionistëve të angazhimit të auditimit përmes burimeve tona të praktikës profesionale (të referuara si Departamenti i Praktikës Profesionale ose DPP). DPP gjithashtu ndihmon ekipet e angazhimit ku ka dallime opinionesh ose brenda ekipeve ose me rishikuesin e Kontrollit të cilësisë së Angazhimit. Ndryshimet e pazgjidhura kërkohen të përshkallëzohen tek partnerët me më shumë eksperiencë për zgjidhje përfundimtare. ISG është gjithashtu në dispozicion për konsultim në rastet kur diçka e tillë kërkohet.

Politikat ndërkombëtare të KPMG-së përfshijnë kërkesat minimale për DPP-të e shoqërive anëtare.

### 3.8.5 Të zhvilluarit e kuptueshmërisë së biznesit dhe njohuritë e industrisë

Një ndër pjesët kryesore të cilësisë së angazhimit është të paturit e një kuptueshmërie të detajuar të biznesit dhe industrisë së klientit.

Për industri të rëndësishme, janë caktuar udhëzime globale në sektorin e auditimit, për të mbështetur sigurimin e informacionit të nevojshëm mbi industrinë, i cili është i aksesueshëm për të gjithë

profesionistët e auditimit nëpërmjet strukturës së punës së auditimit. Kjo njohuri përmbledh shembuj procedurash të auditimit për industrinë dhe informacione të tjera (si rreziqet tipike dhe proceset kontabël).

Për më tepër, vëzhgimet e industrisë janë të disponueshme dhe sigurojnë informacion mbi biznesin dhe informacion të përgjithshëm për industri të veçanta, sikurse edhe një përmbledhje të njohurisë së industrisë të dhënë në strukturën e punës së auditimit në KPMG.

## 3.9 Kryerja e auditimeve efektive dhe efikase

Mënyra sesi kryhet një auditim është po aq e rëndësishme sa edhe rezultati përfundimtar. Profesionistët e KPMG Albania duhet të demonstrojnë sjellje të caktuara dhe të ndjekin politikat dhe procedurat e caktuara për kryerjen e auditimeve efektive dhe efikase.

### 3.9.1 Këshillimi i vazhdueshëm, mbikëqyrja dhe rishikimi i punës

Ne kuptojmë që aftësitë ndërtohen përgjatë kohës dhe përmes përbaljes me eksperiencë të ndryshme. Për të investuar në ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të profesionistëve tanë, pa bërë kompromis me cilësinë, KPMG Albania promovon një ambient të vazhdueshëm të mësuari dhe mbështet kulturën e trajnimit.

Partneri dhe drejtuesi i angazhimit, i mbështetur nga menaxherët e angazhimit, është përgjegjës për drejtimin e një kulture të stërvitjes dhe mësimi të vazhdueshëm gjatë gjithë procesit të auditimit dhe përcaktimin e një shembulli në kryerjen e auditimit për të nxitur një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së auditimit.

Ndjekja e progresit të vazhdueshëm, trajnimi dhe mbikëqyrja e punës gjatë një auditimi përfshin:

- Pjesëmarrjen e partnerit ose drejtuesit të angazhimit në diskutimet planifikuese
- Ndjekjen e progresit të angazhimit të auditimit
- Marrjen parasysh të kompetencës dhe aftësive të anëtarëve individualë të ekipit të auditimit, duke përfshirë nëse ata kanë kohë të mjaftueshme për të bërë punën e tyre, nëse ata i kuptojnë udhëzimet, dhe nëse puna po bëhet në përputhje me përjasjen e planifikuar të angazhimit

- Ngritjen e çdo çështjeje të rëndësishme që lind gjatë angazhimit, duke marrë parasysh domethënien e tyre dhe duke modifikuar në mënyrën e duhur përjasjen e planifikuar dhe
- Identifikimin e çështjeve për këshillim me anëtarë të ekipit me më shumë eksperiencë gjatë angazhimit.

Një pjesë kyçe e mbikëqyrjes efektive është rishikimi në kohë i punës së bërë në mënyrë që çështjet e rëndësishme të identifikohen dhe adresohen shpejt.

### Rishikuesit e kontrollit të cilësisë së angazhimit (EQC)

Rishikuesit EQC janë të pavarur nga ekipi i angazhimit dhe kanë eksperiencën dhe njohuritë e nevojshme për të kryer një rishikim objektiv më kritik të vendimeve dhe gjykimeve të bëra nga ekipi i auditimit dhe mbi përshtatshmërinë e pasqyrave financiare.

Një rishikues EQC kërkohet që të caktohet për auditimet e çdo rishikimi të lidhura të informacionit financiar të ndërmjetëm, të gjitha subjekteve të listuara, subjektet jo të listuara me një interes të lartë publik, angazhimet që kërkojnë një rishikim EQC sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, angazhime me rrezik të lartë si dhe angazhimet e tjera të përcaktuara nga Partneri i Menaxhimit të Rrezikut apo Drejtuesi i Auditit në vend. Rishikimi EQC bëhet para datës së raportit të auditorëve dhe ndër të tjera përfshin:

- Rishikimin e dokumentacionit të zgjedhur të auditimit në lidhje me gjykimet e rëndësishme të bëra nga ekipi i angazhimit dhe konkluzionet e arritura
- Rishikimin e pasqyrave financiare dhe raportit të propozuar të auditorit; dhe
- Vlerësimin e konkluzioneve të arritura në formulimin e raportit të auditorëve dhe marrja në konsideratë nëse raporti i propozuar është i përshtatshëm.

Edhe pse partneri i angazhimit është përgjegjës për zgjidhjen e çështjeve të auditimit dhe raportimit financiar, rishikuesi EQC duhet të jetë i bindur që të gjitha pyetjet domethënëse të ngritura, kanë gjetur një zgjidhje para përfundimit të auditimit.

KPMG Albania është në kërkim të vazhdueshëm të forcimit dhe përmirësimit të rolit që luan rishikuesi EQC në auditime, meqenëse kjo është një pjesë kyçe e sistemit të kontrollit të cilësisë së auditimit.

Vitet e fundit janë ndërmarrë një sërë veprimesh, për ta ri-forcuar këtë, duke përfshirë:

- Lëshimin e udhëzimeve mbi praktikën e drejtimit, të fokusuar në kompetencat dhe aftësitë e rishikuesit dhe një mbështetje të vazhdueshme të siguruar nga rishikuesit EQC
- Përfshirjen e procedurave specifike në strukturën e punës së auditimit të KPMG-së, për të lehtësuar rishikimet efektive, dhe
- Zbatimin e politikave që kanë të bëjnë me njohjen, emërimin dhe zhvillimin e shqyrtimit EQC, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e natyrës, kohës dhe shkallën e përfshirjes së tyre.
- Marrjen në konsideratë të rolit të kryer nga rishikuesi EQC gjatë kryerjes së procesit të rishikimit të portofolit të partnerëve për të siguruar kohë dhe aftësi të përshtatshme të caktuara për rolin dhe rialokimin nëse është e nevojshme; dhe
- Vlerësimin e punës të kryer nga rishikuesi EQC dhe përshtatshmërinë e përfshirjes duke përfshirë diskutimin me të, si pjesë e Rishikimit të Performancës së Cilësisë sonë.

### Raportimi

Standardet e Auditimit diktojnë formatin dhe përmbajtjen e raportit të auditimit, i cili përfshin një opinion mbi paraqitjen e drejtë në të tëra aspektet materiale të pasqyrave financiare të klientit. Partnerët ose drejtuesit e angazhimit me eksperiencë formulojnë opinionet e auditimit, pas përfshirjes në punën dhe rishikimin e punës të kryer nga ekipi i auditimit.

Në përgatitjen e raporteve të auditimit, partnerët e angazhimit kanë qasje në udhëzime të zgjeruara të raportimit dhe mbështetje teknike për auditimin nëpërmjet konsultimeve me DPP-të tona, veçanërisht kur ka çështje domethënëse për t'iu raportuar përdoruesve të raportit të auditimit (p.sh një modifikim në opinion ose përmes një paragrafi "Çështje për theksim" ose paragrafi "Çështje të tjera").

### Komunikim i dyanshëm i gjerë, i hapur dhe i ndershëm

Komunikimet e dyanshme me personat që janë në drejtim, shpesh i identifikuar si komiteti i auditimit, është kyçi i cilësisë së një auditimi dhe një aspekt thelbësor i raportimit dhe dhënies së shërbimeve. Te KPMG Albania ne theksojmë rëndësinë e mbajtjes informuar të personave që janë në drejtim, në lidhje

me çështjet që lindin përgjatë auditimit dhe nevojën për të dëgjuar dhe kuptuar pikëpamjet e tyre. Ne e arrijmë këtë përmes një kombinimi të raporteve dhe prezantimeve, pjesëmarrjes në komitetin e auditimit dhe takimet e bordit, dhe kur është e nevojshme diskutime të vazhdueshme me administrimin dhe anëtarët e komitetit të auditimit.

Komunikimi me Komitet e Auditimit përfshin:

- Vështrimin e përgjithshëm i qëllimit të punës dhe kohës së auditimit të planifikuar, i cili përfshin komunikimin e rreziqeve domethënëse të identifikuara
- Gjetjet e rëndësishme të auditimit të cilat mund të përfshijnë mangësi në kontroll dhe anomali në auditim
- Një komunikim vjetor me shkrim ku deklarohet ekipi i angazhimit dhe se KPMG Albania ka vepruar në përputhje me kërkesat përkatëse për pavarësi; përshkruhen të gjitha marrëdhëniet dhe çështje të tjera ndërmjet KPMG Albania dhe klientit të auditimit që, sipas gjykimit tonë profesional, mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në pavarësi; dhe deklarohen masat mbrojtëse të aplikuara për të eliminuar (ose reduktuar në një nivel të pranueshëm) kërcënimet e identifikuara të pavarësisë.

Ne sigurohemi që këto komunikime përmbushin kërkesat e standarteve profesionale të

Institutit të Komitetit të Auditimit. Në njohje të rolit kërkues dhe të rëndësishëm që ka Komiteti i Auditimit në tregjet kapitale dhe gjithashtu të sfidave me të cilat ata përballen në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre, Instituti i Komitetit të Auditimit ('ACI') ka për qëllim të ndihmojë anëtarët e komitetit të auditimit të rritin ndërgjegjësimin e tyre, angazhimin dhe aftësinë për të zbatuar proceset efektive të Komitetit të Auditimit. ACI operon në më shumë se 40 vende në të gjithë globin dhe u ofron anëtarëve të komitetit të auditimit udhëzime autoritare (siç është Manuali i Komitetit të Auditimit të ACI) për çështjet me interes për komitetet e auditimit përditësimet për çështje si reforma e auditimit të BE-së, ndryshime në standardet e kontabilitetit dhe çështje të tjera me interes për komitetet e auditimit (si siguria kibernetike dhe kultura e korporatave); si dhe mundësinë për tu lidhur me kolegët e tyre gjatë një programi intensiv teknikash të reja dhe seminare ndërgjegjësuere.

Ato çfarë ACI ofron mbulojnë një sërë sfidash me të cilat përballen Komitetet e Auditimit dhe bizneset e sotme - nga menaxhimi i rrezikut dhe zhvillimi teknologjik në strategjitë dhe pajtueshmërinë globale.

Instituti Global i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) i KPMG-së ofron informacion dhe burime për të ndihmuar KPMG Albania, anëtarët e Komitetit të Auditimit, drejtuesit, palët e interesuar dhe përfaqësuesit e qeverisë për të fituar njohuri dhe qasje në lidhje me kornizën globale të raportimit financiar.

### 3.9.2 Konfidencialiteti, siguria e informacionit dhe privatësia e të dhënave të klientit

Rëndësia e mbajtjes së konfidencialitetit të klientit theksohet përmes një sërë mekanizmesh duke përfshirë komunikimin e rregullt në temë, Kodin Global të Sjelljes, trajnime, dhe procesin vjetor të dëshmisë/konfirmimit, të cilin duhet ta plotësojnë të gjithë profesionistët e KPMG-së.

Ne kemi një politikë zyrtare të ruajtjes së dokumentit për sa i përket periudhës së ruajtjes së dokumentacionit të auditimit dhe regjistrimeve të tjera të rëndësishme për një angazhim, në përputhje me kërkesat e IESBA sikurse edhe ligje standarte dhe rregullore të tjera të aplikueshme.

Ne kemi politika të qarta mbi sigurinë e informacionit që mbulon një gamë të gjerë fushash. Politikat e Privatësisë së të dhënave ekzistojnë për të drejtuar trajtimin e informacionit personal, së bashku me trajnime shoqëruese, janë të detyrueshme për të gjithë personelin e KPMG Albania.

Jemi të përkushtuar që të sigurojmë një ambient të sigurt për të dhënat personale dhe informacionet konfidenciale që mbajmë, si dhe për mbrojtjen e privatësisë së klientëve tanë, ofruesve të shërbimeve dhe palëve të treta.

Në kuadër të Menaxhimit të Cilësisë & Rrezikut, shoqëria ka një Officer Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të përkushtuar i cili ka autoritetin, aftësitë dhe nevojshme për të kryer funksionin e mbrojtjes së informacionit.

Kërkesat tona për mbrojtjen e informacioneve janë të përcaktuara në Politikën e Sigurisë së Informacionit Global të botuar nga KPMG International. Monitorimi i pajtueshmërisë ndaj këtyre standardeve dhe

politikave kryhet përmes programit tonë të auditimit të brendshëm të sigurisë së informacionit dhe plotësohet me kontrole vjetore nga Grupi Global i Mbrojtjes së Informacionit.

Ne besojmë se gjithkush ka një rol në mbrojtjen e klientit dhe informacionit konfidencial. Politikat dhe praktikat u komunikohen të gjithë personelit dhe, sipas rastit, përfordhet përmes udhëzimit, ndërgjegjësisë dhe trajnimit. Ekzistojnë politikat e privatësisë së të dhënave dhe të sigurisë së informacionit që rregullojnë trajtimin e informacionit personal dhe konfidencial.

### 3.10 Përkushtimi ndaj përmirësimit të vazhdueshëm

KPMG është e angazhuar të përmirësojmë vazhdimisht cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e auditimeve tona. Monitorimi i integruar i cilësisë dhe programet e pajtueshmërisë iu mundësojnë shoqërive anëtare identifikimin e mangësive në cilësi, për të kryer analiza të thella dhe për të zhvilluar, zbatuar dhe raportuar plane veprimi të korigjuara si në lidhje me angazhimet individuale të auditimit edhe në sistemet e kontrollit të cilësisë së KPMG-së. Programet e integruara të cilësisë dhe monitorimit të KPMG International përfshijnë Programin e Rishikimit të Performancës së Cilësisë (QPR), Programin e Përputhshmërisë së Rrezikut (RCP) dhe Programin e Rishikimit të Pajtueshmërisë Globale (GCR).

Programet e monitorimit të cilësisë dhe të pajtueshmërisë administrohen në nivel global dhe të qëndrueshëm dhe janë konsistente në qasjen e tyre në të gjithë shoqëritë anëtare, duke përfshirë natyrën dhe shtrirjen e testimit dhe raportimit. KPMG Albania krahason rezultatet e programeve të brendshme të monitorimit të saj me rezultatet e programeve të inspektimit të jashtme dhe merr masat e duhura.

#### 3.10.1 Programet e Monitorimit të brendshëm dhe pajtueshmërisë

Programet tona të monitorimit vlerësojnë të dyja si më poshtë:

- Performancën e angazhimit në përputhje me standardet e aplikueshme, ligjet në fuqi dhe politikat e rregullat të KPMG International, si edhe:
- Pajtueshmërinë e KPMG Albania me politikat dhe procedurat e KPMG International, rëndësinë, përshtatshmërinë dhe funksionimin efektiv të

politikave dhe procedurave kryesore të kontrollit të cilësisë.

Rezultatet dhe mësimet nga programet e integruara të monitorimit komunikohen në nivel të brendshëm, dhe rezultatet dhe mësimet e përgjithshme nga programet merren në konsiderate dhe veprimet e nevojshme zbatohen në nivel lokal, rajonal dhe global. Programi ynë i monitorimit të brendshëm, gjithashtu kontribuon në testimin e sistemit të kontrollit të cilësisë, nëse është krijuar në mënyrën e duhur apo ka një zbatim dhe funksionim efikas.

Dy programe inspektimi, QPR dhe RCP, zhvillohen dhe administrohen çdo vit nga KPMG International në funksionet e Auditimit, shërbimeve Fiskale dhe të Konsulencës.

Për më tepër, të gjitha shoqëritë anëtare mbulohen nga Rishikimet të paktën në çdo tre vite nga Programet e Përputhshmërisë Globale që janë në mënyrë të ndërthurur funksionale. Pjesëmarrja në programet QPR, RCP, GCR është një kusht i vazhdimësisë së anëtarësisë në rrjetin e KPMG-së.

#### Rishikimet e Performancës së Cilësisë së Auditimit (QPRs)

Programi i QPR vlerëson nivelin e performancës së angazhimit në funksionet Auditim, Taksë dhe Konsulencë dhe identifikon shanset për të përmirësuar cilësinë e angazhimit.

#### Qasje e bazuar në rrezik

Secili nga partnerët ose drejtuesit e angazhimeve përzgjidhet për rishikim të paktën njëherë në një cikël tre-vjeçar. Një qasje e bazuar në rrezik përdoret për të përzgjedhur angazhimet. KPMG Albania zhvillon programin vjetor QPR në përputhje me udhëzimet e QPR ndërkombëtare. Rishikimet kryhen në KPMG Albania dhe monitorohen në nivel rajonal dhe global. Rishikimet e QPR së auditimit të shoqërive anëtare rishikohen nga një rishikues drejtues me përvojë të pavarur nga shoqëria anëtare.

#### Zgjedhja e Rishikuesve, Përgatitja dhe Procesi

Kritere të qëndrueshme përdoren për përzgjedhjen e rishikuesve. Ekipet e rishikimit përbehen nga rishikues drejtues me përvojë që janë të pavarur nga shoqëria anëtare që i nënshtrohet rishikimit.

Jepen trajnime për ekipet e rishikimit dhe persona të tjerë që mbikëqyrin procesin, me fokus në çështjet e interesit të identifikuara nga rregullatorët

mbikëqyrës të auditimit dhe nevojën për të qenë sa më rigoroz si rishikues të jashtëm.

### Vlerësimet nga QPR e Auditimit

Janë përdorur kritere të qëndrueshme për të përcaktuar vlerësimet e angazhimit dhe vlerësimet e praktikave të auditimit të shoqërive anëtare. Angazhimet e auditimit të përzgjedhura për rishikim vlerësohen si: "Të kënaqshme" "Përmirësim i Nevojshëm Performance", ose "Të pakënaqshme".

### Raportimi

Ne i shpërndajmë gjetjet tona nga programi i QPR tek profesionistët tanë përmes komunikimeve të shkruara, mjeteve të trajnimeve të brendshme dhe takimeve periodike të partnerëve, manaxherëve dhe stafit.

Këto fusha gjithashtu vihen në dukje në programe vijuese inspektimi për të matur masën e përmirësimit të vazhdueshëm.

Partnerët drejtues të angazhimit të auditimit njoftohen për angazhimet e tyre përtej kufijve

(të përcaktuara si "Përmirësimi i Performancës së Nevojshme" ose "Të Pakënaqshme") për të cilat vlerësimet janë më të ulëta se të kënaqshme.

Për më tepër, partnerët drejtues të angazhimit të Shoqërive mëmë/zyrat qendrore njoftohen kur një filial/anëtarë i grupit të klientit të tyre auditohet nga një shoqëri anëtare dhe ku janë identifikuar çështje të cilësisë gjatë auditimit QPR.

### Programi i Përputhshmërisë së Rrezikut (RCP)

KPMG International zhvillon dhe mban politika të kontrollit të cilësisë dhe procese që aplikohen për të gjitha shoqëritë anëtare. Këto politika si dhe proceset dhe procedurat e lidhura me to, janë të përfshira në kërkesat e ISQC-1.

Gjatë RCP-së vjetore, ne kryejmë një program të qëndrueshëm vlerësimi të përbërë nga dokumentimi i procedurave të kontrollit të cilësisë, testimi i duhur i përputhshmërisë dhe raportimi i përjashtimeve, planeve të veprimit dhe përfundimeve.

Objektivat e RCP janë:

- Monitorimi, dokumentimi dhe vlerësimi i shkallës së përputhshmërisë së sistemit të cilësisë së KPMG Albania me politikat e sistemit Global të

Cilësisë dhe Menaxhimit të Rrezikut si dhe me kërkesat kryesore ligjore dhe rregullatore lidhur me ofrimin e shërbimeve profesionale

- Të sigurojë bazën për KPMG Albania për të vlerësuar nëse kjo shoqëri anëtare dhe personeli i saj janë në përputhje me standardet profesionale

dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi

Aty ku identifikohen mangësi ne na kërkohet të vëmë në zbatim plane të përshtatshme veprimi dhe të monitorojmë statusin e çdo plani veprimi.

### Programi i Rishikimit të Përputhshmërisë Globale (GCR)

Çdo shoqëri anëtare i nënshtrohet një GCR-je të kryer nga ekipi i GCR të KPMG ndërkombëtare, të pavarur nga shoqëria anëtare, të paktën një herë çdo 3 vjet.

Ekipi i GCR-së që kryen rishikimet është i pavarur nga shoqëria anëtare e KPMG-së dhe është objektiv dhe me njohuri për politikën globale të menaxhimit të cilësisë dhe rrezikut. GCR-të vlerësojnë pajtueshmërinë me politikën dhe procedurat e përzgjedhura të KPMG International dhe ndajnë praktikën më të mira midis shoqërive anëtare.

GCR siguron vlerësim të pavarur të:

- Angazhimit të shoqërisë anëtare ndaj cilësisë dhe menaxhimit të rrezikut (tone at the top) dhe shkallën në të cilën struktura e përgjithshme e saj, qeverisja dhe financimi mbështesin dhe përforcojnë këtë angazhim
- Pajtueshmërisë e një shoqërie anëtare me politikën dhe procedurat kryesore të KPMG-së; dhe
- Qëndrueshmërisë me të cilën shoqëria anëtare kryen programin e saj të pajtueshmërisë (RCP).

Ne zhvillojmë plane veprimi për t'iu përgjigjur të gjithë gjetjeve të GCR si dhe ti dakortësojë këto gjetje me ekipin GCR. Progresi ynë në planet e veprimit monitorohet nga Ekipi Qendror i GCR.


Rezultatet raportohen pranë Grupit Drejtues të Cilësisë Globale dhe Menaxhimit të Rrezikut (GORMSG), dhe kur është e nevojshme raportohen pranë udhëheqjes së KPMG International dhe rajonale, për të ndihmuar në sigurimin e veprimeve

përmirësuese në kohë të ndërrmarra nga shoqëria anëtare.

### Analiza e Thelbit të Problemit (RCA)

KPMG Albania kryen analiza të thelbit të problemit për të identifikuar dhe adresuar çështjet e cilësisë së auditimit me qëllim parandalimin e përsëritjes së tyre dhe të ndihmojë në identifikimin e praktikave të mira si pjesë e përmirësimit të vazhdueshëm.

Hapat e Parimeve të RCA Globale janë si më poshtë:



Është përgjegjësi e shoqërive anëtare të kryejnë analiza të thelbit të problemit dhe në këtë mënyrë të identifikojnë dhe më pas të zhvillojnë planet e duhura për zgjidhjen e çështjeve të cilësisë së auditimit të identifikuar.

Drejtuesi i Auditimit të KPMG Albania është përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të veprimit si rezultat i RCA, duke përfshirë identifikimin e zotëruesve të zgjidhjes. Partneri i Menaxhimit të Rrezikut monitoron zbatimin e tyre.

Gjatë vitit të kaluar ne kemi rritur ndjeshëm formalitetin e Analizës së Thelbit të Problemit. RCA kryhet nga një ekip i trajnuar në metodologjinë tonë të Analizës së Thelbit të Problemit Global prej 5 hapash dhe e pavarur nga ekipi i angazhimit.

Rezultati i këtij procesi është rritja e dukshmërisë së faktorëve bazë në nivelin e angazhimit që pengon ofrimin konsistent të auditimeve të cilësisë së lartë. Kjo dukuri e përmirësuar na lejon të zhvillojmë veprime më inteligjente dhe të fokusuar. Këto veprime janë më të gjera se trajnimet, mjetet dhe

udhëzimet dhe janë të dizajnuara për të trajtuar çështjet e sjelljes dhe ato strukturore përveç fushave të tilla si njohuritë teknike dhe shpërndarjen e punës.

### 3.10.2 Rekomandime për përmirësim

Në nivel global, nëpërmjet Këshillit të Çështjeve të Cilësisë së Auditimit Global (GAQIC) dhe Grupi Drejtues i Menaxhimit dhe të Rrezikut Global (GO&RMSG), KPMG International rishikon rezultatet e programeve të monitorimit të cilësisë, analizon shkaqet rrënjësore të shoqërive anëtare dhe planet e veprimit dhe zhvillon veprime shtesë globale siç kërkohet.

Deri më sot, planet e rehabilitimit global të zhvilluara nga KPMG Ndërkombëtare kanë synuar ndryshimin e kulturës dhe sjelljes në të gjithë rrjetin e KPMG dhe në ngritjen e performancës së ekipit të angazhimit në shoqëritë anëtare të KPMG. Planet e rehabilitimit janë zbatuar përmes zhvillimit të trajnimeve globale, mjeteve dhe udhëzimeve për të ngulitur qëndrueshmërinë, duke siguruar që bazat janë të drejta dhe se praktika më e mirë është e shpërndarë në të gjithë rrjetin e KPMG-së.

### 3.10.3 Dialogu dhe reagimi (feedback) jashtë shoqërisë

#### Rregullatorët

Gjatë dhjetorit 2018 Bordi i Mbikëqyrjes Publike filloi rishikimin më të fundit të periodik të sistemeve të brendshme të kontrollit të cilësisë të praktikave të auditimit të KPMG Albania.

Qëllimi i rishikimit ishte të vlerësohej implementimi i sistemeve të brendshme të kontrollit të cilësisë në angazhimet e auditimit; kërkesat rregullatore dhe statutorë; përputhshmëria me kërkesat etike të Kodit të Etikës (IESBA); dhe nëse angazhimet e rishikuara të auditimit janë zhvilluar dhe raportuar në përputhje me standartet profesionale të aplikuar në të gjitha drejtimet respektive. Rishikimet mbuluan respektivisht periudhat 1 janar 2017 – 31 dhjetor 2017. Bordi ka konkluduar se kontrollet e brendshme të KPMG Albania ishin krijuar në mënyrë të përshtatshme dhe të tilla që të ofrojnë siguri bindëse se funksionojnë dhe raportojnë në përputhje me standartet profesionale në të gjitha aspektet materiale. Angazhimet e përgjeshura të auditimit që u rishikuan, u vlerësuan si të kryera në përputhje me standartet profesionale në të gjitha aspektet materiale.

Si pjesë e kontrollit të cilësisë dhe kërkesave për transparencë në praktikën e auditimit, KPMG Albania mban një listë të shoqërive me interes publik të audituara nga shoqëria për vitin financiar që mbyllet më 31 dhjetor 2018. Kjo listë ndodhet në [Shtojcën 1 të raportit: Subjekte me interes publik](#).

KPMG International ka komunikim të rregull të dyanshëm me Federatën Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFAR) për të diskutuar gjetjet e cilësisë së auditimit dhe veprimet e ndërmarra për të adresuar çështje të tilla në nivel rrjeti. Në nivel rajonal, ne gjithashtu kemi dialog të rregullt me përfaqësuesit e Komitetit të Organeve Europiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (CEAOB) - i njohur më parë si Grupi European i Inspektimit të Auditimit (EAIG).

### Reagimi nga klientët

Ne në mënyrë aktive kërkojmë reagime nga klientët nëpërmjet bisedave personale dhe anketave të palëve të treta për të monitoruar nivelin e kënaqshmërisë për shërbimet e dhëna. Ne përpiqemi që me anë të këtyre reagimeve të bëjmë ndryshime dinamike në nivel angazhimi dhe nivel shoqërie për të përmbushur nevojat e klientëve.

### Monitorimi i ankesave

Ne kemi vendosur procedura për monitorimin dhe adresimin e ankesave të marra në lidhje me cilësinë e punës sonë. Këto procedura përmenden në kushtet tona të përgjithshme të marrëveshjes.

### Vlerësime të tjera të cilësisë së auditimit

Ne zbatojmë gjithashtu procese të tjera shtesë për të vlerësuar cilësinë e auditimit si, rishikim para lëshimit të pasqyrave financiare të klientit.



# Informacioni financiar

## Seksioni 4

Paraqitur më poshtë është informacioni financiar në lidhje me qarkullimin e përgjithshëm të KPMG Albania i ndarë në kategori:

	2018 Të ardhura në Lekë '000	2017 Të ardhura në Lekë '000
Auditim Ligjor	37,648	55,048
Shërbime të tjera Auditimit	31,426	23,620
Shërbime Fiskale dhe Konsulence	91,138	102,452
<b>Total</b>	<b>160,212</b>	<b>181,120</b>

# Shpërblimi i partnerit

## Seksioni 5

Sistemi i shpërblimit të partnerëve bazohet në parimet e përgjithshme të zbatuara nga Bordi Rajonal i KPMG në Europën Qendrore dhe Lindore dhe është projektuar për të reflektuar përgjegjësitë dhe eksperiencën individuale të një partneri, rolin e tyre për administrimin e praktikave profesionale dhe të shoqërisë si një të tërë, si edhe kushtet e tregut vendas. Këto objektiva për secilin partner mbulojnë indikatorë financiarë dhe sjellin rritje në të ardhura dhe përfitim si dhe në cilësinë e punës dhe ekselencën në shërbimin ndaj klientit, leadership dhe në të jetuarit e vlerave të shoqërisë.

Përcaktimi i shpërblimit të partnerëve bëhet nga Partneri Ekzekutiv pasi konsultohet me Drejtorin e Bordit të KPMG në Europën Qendrore dhe Lindore. Shpërblimi ka dy elementë:

- Baza – ky është shpërblim që përcaktohet nga përqindja e fitimeve të buxhetuara të shoqërisë. Shuma e komponentit bazë pasqyron rolin dhe vjetërsinë e secilit partner; dhe
- Komponenti që ka lidhje me performancën në fitim pasqyron performancën vjetore të çdo partneri kundrejt objektivave individuale, atë të funksionit relevant dhe kontributin e tij/saj në zhvillimin e shoqërisë.

Shuma për komponentin që ka lidhje me performancën në fitim që jepet në fund të vitit financiar varet nga performanca e partnerit dhe nga disponueshmëria e fitimeve të ndashme.

# Rregullimi i Rrjetit

## Seksioni 6

KPMG INTERNATIONAL VENDOS DHE BËN TË MUNDUR ZBATIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E POLITIKAVE DHE STANDARDEVE UNIFORMË NË PUNË.

### 6.1 Struktura Ligjore

Rrjetit i KPMG i janë bashkuar KPMG International, një kooperativë Zviceriane që është një entitet ligjor i krijuar nën ligjin Zvicerian.

KPMG International merret me mbarëvajtjen e aktiviteteve të biznesit në të mirë të të gjithë rrjetit të KPMG dhe shoqërive anëtare por nuk ofron shërbime profesionale për klientë. Shërbimet profesionale klientëve u ofrohen ekskluzivisht prej shoqërive anëtare.

Një nga qëllimet kryesore të KPMG International është të ndihmojë shoqëritë anëtare të japin shërbime cilësore klientëve të tyre, në auditim, taksë dhe konsulencë. KPMG International vendos dhe ndihmon në praktikimin dhe mbarëvajtjen e rregullave dhe standardeve uniformë të punës së bërë nga shoqëritë anëtare dhe mbron dhe zhvillon përdorimin e emrit të KPMG dhe markës së saj.

KPMG International është një entitet ligjor i ndarë prej çdo shoqëri anëtare. KPMG International dhe shoqëritë anëtare nuk janë një partnership global, sipërmarrje e përbashkët apo partnership me njëra tjetrën. Asnjë prej shoqërive anëtare nuk ka autoritetin që të detyrojë apo shtrëngojë KPMG International apo çdo shoqëri tjetër anëtare ballë për ballë si palë të tretë, ashtu sikurse KPMG International nuk e ka këtë autoritet që të detyrojë apo shtrëngojë ndonjë prej shoqërive anëtare. Më tepër informacion për rrjetin e KPMG mund të gjendet në [Raportin Rishikues Vjetor Ndërkombëtar 2018](#).

### 6.2 Përgjegjësitë dhe detyrimet e Shoqërive anëtare

Sipas marrëveshjeve me KPMG International, shoqëritë anëtare duhet të jenë në përputhje me politikën dhe rregulloret e KPMG International duke përfshirë standardet e cilësisë që qeverisin se si ato veprojnë dhe si ofrojnë shërbime për klientët për të konkurruar në mënyrë efektive. Kjo përfshin krijimin e një strukture të fortë që siguron vazhdimësi dhe stabilitet dhe të jetë në gjendje të miratojë strategji globale, të ndajë burimet (hyrëse dhe dalëse), klientët shumëkombësh të shërbimit, menaxhimin e rrezikut dhe vendosjen e metodologjive dhe mjeteve globale.

Çdo shoqëri anëtare merr përgjegjësinë për drejtimin e saj dhe cilësinë e punës së saj. Shoqëritë anëtare angazhohen për një grup të përbashkët të vlerave të KPMG.

Aktivitetet e KPMG International financohen nga shumata e paguara nga shoqëritë anëtare. Baza për llogaritjen e këtyre shumave miratohet nga Bordi Global dhe zbatohet në mënyrë konsistente në shoqëritë anëtare. Statusi i një shoqërie si një firmë anëtare e KPMG dhe pjesëmarrja e saj në rrjetin KPMG mund të ndërpritet nëse, ndër të tjera, nuk është në pajtim me politikën dhe rregulloret e përcaktuara nga KPMG International ose ndonjë nga detyrimet e tjera që i detyrohen KPMG International.

### 6.3 Sigurimi i dëmshpërblimit profesional

Mbahet një nivel i konsiderueshëm mbulimi i sigurimit në lidhje me pretendimet për neglizhencë profesionale. Mbulimi siguron një mbulim territorial në të gjithë botën dhe kryhet kryesisht nëpërmjet një siguresi në dispozicion për të gjitha shoqëritë anëtare KPMG.

## 6.4 Struktura e qeverisjes

Strukturat kryesore të qeverisjes dhe drejtimit të KPMG International janë Këshilli Global, Bordi Global dhe Ekipi Ekzekutiv Global. Detaje të mëtejshme për strukturën qeverisëse të KPMG International mund të gjenden në [Raporti i Transparencës së KPMG International 2018](#).

## 6.5 Drejtuesit për Cilësinë Rajonale dhe Menaxhimin e Rrezikut

Drejtuesi Global i Menaxhimit të Cilësisë dhe Rrezikut emëron Drejtuesit e Cilësisë Rajonale dhe Menaxhimit të Rrezikut (ARL) të cilët ofrojnë një funksion të rregullt dhe të vazhdueshëm të monitorimit dhe konsultimit për të vlerësuar efektivitetin e përpjekjeve dhe proceseve të një shoqërie anëtare për të identifikuar, menaxhuar dhe raportuar rreziqe të rëndësishme që mund të dëmtojnë emrin e KPMG. Aktivitetet e rëndësishme të ARL, duke përfshirë çështjet e shoqërisë anëtare të identifikuara dhe përgjigjet lidhur me shoqërinë anëtare, i raportohen drejtuesve të GQ & RM:

Objektivat e rolit të ARL janë:

- Të ndihmojë drejtuesit e GQ & RM në monitorimin e aktiviteteve të cilësisë dhe rrezikut të shoqërive anëtare;
- Të punojë me drejtuesit e GQ & RM dhe zyrën ndërkombëtare të këshillit të përgjithshëm (iogc) kur çështjet e rëndësishme të emrit dhe të rrezikut të ligjit ndodhin për të ndihmuar në sigurimin e trajtimit të duhur të çështjeve; dhe
- Të monitorojë efektivitetin e përmirësimit të shoqërisë anëtare për çështje të rëndësishme, duke përfshirë identifikimin e shkakut rrënjësor të incidenteve serioze të cilësisë.

# Deklarata e drejtuesve të KPMG Albania mbi efektivitetin e kontrolleve të cilësisë dhe pavarësisë

## Seksioni 7

Masat dhe procedurat që shërbejnë si baza për sistemin e kontrollit të cilësisë për KPMG Albania të përmendura në këtë raport kanë si qëllim të sigurojnë një shkallë sigurie të arsyeshme se auditimet ligjore të kryera nga shoqëria jonë janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në zbatim. Për shkak të kufizimeve të brendshme, sistemi i kontrollit të cilësisë nuk synon të japë siguri absolute që mospërputhjet ndaj ligjeve dhe rregulloreve relevante do të ndalohen apo zbulohen.

Drejtuesit e KPMG Albania kanë konsideruar sa më poshtë:

- Krijimin dhe operimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë siç përshkruhen në këtë raport
- Gjetjet prej programeve të ndryshme të përputhshmërisë të realizuara nga shoqëria jonë (përfshirë këtu Programet e Rishikimit të KPMG International siç përshkruhet në seksionin Monitorimi i Brendshëm dhe pajtueshmërisë) dhe
- Gjetjet, nëse ka, prej inspektimeve të rregullatorëve dhe vijimësinë e mëtejshme dhe/ose veprimet korigjuese.

Duke marrë të gjithë këto evidenca së bashku, drejtuesit e KPMG Albania konfirmojnë me një shkallë sigurie të arsyeshme se sistemet e kontrollit të cilësisë brenda shoqërisë sonë kanë operuar efektivisht për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

Për më tepër, drejtuesit e KPMG Albania konfirmojnë se një shqyrtim i brendshëm i pajtueshmërisë së pavarësisë brenda shoqërisë sonë është kryer gjatë vitit të kaluar.

**Tiranë, 29 Mars 2019**

**KPMG Albania**

# Shtojca 1: Subjekte me Interes Publik:

Përkufizimi i subjekteve me interes publik është si më poshtë:

Sipas Kodit të Etikës të IESBA-së, entitetet me interes publik janë:

- Të gjitha subjektet e listuar; dhe
- Çdo subjekt
- I përkufizuar prej rregulloreve apo legjislacionit si subjekt me interes publik ose
- për të cilat rregulloret dhe legjislacioni kërkojnë që auditimi të realizohet në përputhje me kërkesat për pavarësi që aplikohen për auditimin e shoqërive të listuara. Kjo rregullore mund të shpallet nga çdo rregullator përkatës, duke përfshirë edhe rregullatorët e auditimit.

Sipas kërkesave të Ligjit mbi Auditimin entitetet që auditohen dhe prezantohen në raportin e transparencës janë:

- Subjekte të listuara:
- Banka dhe institucione financiare jo-bankare të licencuara nga Banka e Shqipërisë
- Shoqëri sigurimi dhe risigurimi, institucione të administrimit të fondeve të pensioneve private dhe të investimeve

Subjekte të tjera publike apo private me interes publik për shkak të madhësisë dhe natyrës për tu përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Lista e klientëve të auditit që janë subjekte me interes publik, të audituara nga KPMG Albania për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe që kërkohet të publikohet në raportin e transparencës është si më poshtë:

- Banka e Shqipërisë
- Intesa SanPaolo Bank Albania SHA
- Raiffeisen Bank Sh.a.
- Raiffeisen INVEST Sh.a
- Raiffeisen Leasing Sh.A.
- SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA Sh.a
- SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a
- SH.A.FP SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a

# Vlerat e KPMG-së

**Ne udhëheqim përmes shembullit** në të gjitha nivelet në mënyrë të tillë që të japim shembullin e asaj që presim prej njëri tjetrit dhe prej klientëve tanë.

**Ne punojmë së bashku** të në menyrë që nxjerrim më të mirën e njëri tjetrit dhe krijojmë marrëdhënie pune të forta dhe të suksesshme.

**Ne respektojmë individët** për atë që ata janë dhe për dijet e tyre, aftësitë dhe eksperiencën si individë dhe anëtarë ekuipi.

**Ne kërkojmë fakte dhe sigurojmë informacione** përmes supozimeve sfiduese dhe duke ndjekur faktet, ne kemi forcuar reputacionin tonë për të siguruar informacione si këshilltarë të besueshëm dhe objektivë biznesi.

**Ne jemi të hapur dhe të ndershëm në komunikimin tonë dhe** ne shkëmbejmë shpesh informacion, njohuri dhe këshilla si dhe menaxhojmë në mënyrë konstruktive situatat e vështira me guxim dhe duke qënë të hapur.

**Ne u përkushtohemi komuniteteve tona** duke vepruar si qytetarë të përgjegjshëm, duke zgjeruar aftësitë, eksperiencën dhe perspektivën tonë përmes punës në komunitetin tonë.

**Integriteti** është një karakteristikë kritike që palët e interesuara presin dhe mbi të cilin mbështeten. Prandaj, mbi të gjitha **ne veprojmë me integritet** dhe përpiqemi vazhdimisht të respektojmë standardet më të larta profesionale, të sigurojmë këshilla të forta dhe të ruajmë me rigorozitet pavarësinë tonë.

## **KPMG Albania Shpk**

Deshmoret e Kombit Blvd.

Twin Towers Buildings,  
Building 1, floor 13

Tel.: +355 4 2274 524

Fax: +355 4 2235 534

[\*\*al-office@kpmg.com\*\*](mailto:al-office@kpmg.com)

[\*\*kpmg.com/al\*\*](http://kpmg.com/al)



Informacioni i mëposhtëm, është i natyrës së përgjithshme dhe nuk ka për qëllim t'i adresohet rrethanave të veçanta të ndonjë individi apo shoqërie. Edhe pse ne përpiqemi të sigurojmë një informacion të saktë dhe aktual, ne nuk garantojmë që informacioni i marrë është i saktë në datën e marrjes apo që do të vazhdojë të jetë i saktë në të ardhmen. Ky informacion nuk mund të përdoret nga askush, pa një këshillim profesional të përshtatshëm pas një shqyrtimi të hollësishëm të çështjes konkrete.

© 2019 KPMG Albania Shpk, është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar dhe anëtare e rrjetit të shoqërive të pavarura të lidhura me KPMG International Cooperative ("KPMG International"), një subjekt Zviceran. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Emri dhe logo e KPMG-së, janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të KPMG International.